**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Kuvendi i Komunës Rahovec***
*Skupština Opština Rahovac/Municipality of Rahovec*

**01 Nr. 8/25**
**Rahovec, 20.8.2025**

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal që të marrin pjesë në mbledhjen e **tetë (8),** e cila do të mbahet më **29 gusht 2025 (e premte),** me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje, propozoj këtë:

## REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhurimin e loptopave anëtarëve të Kuvendit të Komunës;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e deklaratës për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike;
5. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2024;
6. Shqyrtimi i informatës për gjendjen e mbeturinave në komunën e Rahovecit;
7. Shqyrtimi i informatës rreth aktiviteteve për nder të Muajit të Mërgimtarëve për vitin 2025.
8. Shqyrtimi i raportit për zbatimin e Planit të Integritetit, janar-qershor 2025.

**KRYESUESI I KUVENDIT**

**Arbër Zenuni**

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **24.07.2025,** me fillim në orën **10:00.** Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Arbër Zenuni**. Në fillim kryesuesi konstatoi se kuorumi për mbajtjen e mbledhjes ekziston. Në fillim të mbledhjes, nga 31 anëtarë, të pranishëm kanë qenë 24.
**Kryesuesi:** Përshëndetje për të gjithë! I nderuar Kryetar i Komunës, **z. Smajl Latifi**, Nënkryetar **z. Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, medie, të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit. Në seancë të pranishëm i kemi edhe zyrtarët nga KRU Gjakova, Drejtorin teknik z. Visar Hasi dhe udhëheqës i njësisë së K.R.U. "Gjakova" - dega në Rahovec, z. Hamid Mullaabazi. Për këtë mbledhje të **shtatë** me radhë të vitit 2025, së bashku me kryetarin, kemi vendosur për këtë rend dite:

### REND DITE

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve;**
3. **Shqyrtimi i Raportit 6 - mujor i punës së Zyrës së Prokurimit për vitin 2025;**
4. **Shqyrtimi i Raportit të DKA-së rreth përfundimit të vitit mësimor, 2024/2025;**
5. **Shqyrtimi i Raportit Financiar, janar - qershor 2025;**
6. **Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Rahovecit për vitin 2024;**
7. **Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, janar – qershor 2025;**
8. **Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, janar – qershor 2025.**

**Shtesë:**

1. **Informatë për furnizim me ujë të pijshëm dhe mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimeve në komunën e Rahovecit;**
2. **Deklaratë kundër fyerjes së UÇK-së nga Igor Popoviq;**

**Sejfullah Sejfullahu:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje kryetar, nënkryetar, asambleistë, vëzhgues! E kam një pikë shtesë të rendit të ditës, nëse e aprovoni dhe nëse e sheh të arsyeshme zyra ligjore. Propozimi im është: Diskutim rreth deklarimeve të nënkryetarit të listës serbe Igor Popoviq, me fyerjen që ia ka bërë UÇK-së në Hoqë të Madhe. Irritim im është jo personal, sepse ai e ka fyer UÇK-në midis Rahovecit. Gjithashtu, ne e kemi një Këshill të Hoqës së Madhe që e financojmë, që janë të barabartë dhe as në mire individuale e as kolektive nuk janë distancuar prej atij deklarimi. Propozoj që ky diskutim të futet në rend dite dhe mund të dalim me ndonjë rezolutë apo deklaratë, ku do ta dënonim deklaratën e tij që UÇK-në e ka quajtur terroriste, 26 vite pas sacrificës së luftes sublike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
**Kryetari:** I nderuar kryesues, anëtarë të kuvendit, media, bashkëpunëtorë, pjesëtarë të KFOR-it, monitorues. Pajtohem plotësisht me ato që u deklaruar dhe besoj që organet tona kompetente i kanë dhënë një përgjigje për këto tendenca që cënojnë vlerat e UÇK-së. Unë e kam një propozim konkret, meqenëse rasti është në procedure, i propozoj Burimit, Sefës, Rumirit, Defrimit dhe ta nxjerrim një deklaratë që distancohemi nga gjuha e urrejtjes, gjuha që sulmon të

arriturat, gjakun, sakrificën etj... Në këtë deklaratë nënshkruajnë të përfaqësuesit e partive politike dhe nëse është nevoja do të nënshkruaj edhe unë. Kjo ka ndodh në Rahovec, mirëpo nuk ka vend për atë gjuhë, as në Rahovec, as në Republikën e Kosovës. Nuk jam që të futet në rend dite, por ta nxjerrim një deklaratë që dënon këtë gjuhë dhe ato sulme të fjalëve, do të ishte e nevojshme ta bënim unanimisht si Kuvend i Komunës së Rahovecit.
**Burim Krasniqi:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje ekzekutiv, kolegë asambleistë, monitorues, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të mediave. Nuk i duhet Rahovecit që të vie dikush brenda për të nxitur urrejtje ndëretnike, sepse është e papranueshme. Rahovecit i duhet një qetësi dhe përkundër viktimave dhe ngjarjeve të përjetuara, ka pranuar që pavarësisht bindjeve fetare dhe nacionalitetit, secili nga ne të arrijë të integrohet brenda komunës së Rahovecit. Kosova është e gjithë qytetarëve të Rahovecit që jetojnë këtu, por nuk i duhet asnjë element, i cili në një formë ose tjetrën arrin të krijoj urrejtje në baza nacionale për përfitime të caktuara, pavarësisht vendit ose lokacionit. Propozoj që, administrata apo kushdo prej zyrtarëve brenda, le ta shkruan një deklaratë në emër të asambleistëve dhe ne këtu jemi të gatshëm ta përkrahim dhe ta votojmë. Një deklaratë, e cila nuk lejon fyerjen nga askush për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, sepse ka qenë një luftë për çlirimin e Kosovës, nuk ka qenë luftë me serbët lokalë të Kosovës dhe kjo është arsyeja pse ata janë këtu, Kosova i pranon dhe i ka krijuar hapësirë duke e diskriminuar pjesën tjetër të populates, për t'i krijuar atyre integrim të plotë. Për mua si kryetar i LDK-së në Rahovec, por edhe në nivel qëndror, është e papranueshme që dikush të vijë kudo në Rahovec dhe të ngjallë urrejtje ndëretnike për qytetarët e komunës së Rahovecit. Rahovecit i duhet tejkalim i situatës, integrim i të gjithëve, zhvillim, jo urrejte, jo ndarje, jo enklavizim, jo forcimit i pikave të zeza brenda komunës së Rahovecit. Kryetar, përveç deklaratës të rekomandoj që ta ftosh këshillit e fshatit Hoçë e Madhe për një takim, duke pasur parasysh që janë banorë të Hoqës, përfaqësues të kishës dhe përfaqësues të asamblesë komunale, megjithatë i rëndësishëm është bashkëbisedimi me njërëzit e Hoçës së Madhe. Për fund, deklaratën le ta shkruan dikush prej zyrtarëve të komunës, sepse ne si asamble nëse e shkruajmë duhet t'i ndajmë mbi 2 orë dhe në fund e votojmë pa telashe.
**Kryetari:** Brenda një ore – një orë e gjysmë, bëhet gati teksti dhe pastaj një konsultim me shefat e grupeve politike dhe ta miratojmë në kuvend. Për veprimet të tjera që ta takojmë Këshillin e fshatit, do t'i shohim situatat. Për momentin, kjo deklaratë është e nevojshme.
**Sejfullah Sejfullahu:** Faleminderit kryetar dhe Burim! Nuk po nguli këmbë që me patjetër të futet në rend dite, që procesit atje mos t'i pengojë, por gjithësesi, qëllimi im është që të dalim me deklaratë dhe në përgjithësi duhet t'i ftojmë për një takim Këshillin e fshatit Hoçë e Madhe. Propozimi im është që në deklaratë atij zotniut t'ia ndalojmë hyrjen në Kosovë, nëse jo në Kosovë, të paktën në komunë të Rahovecit. Më falni në shprehje, ai mund me "hangër" prej Beogradit, por jo prej këtu.
**Kryetari:** Insistoj që edhe ju të jeni të përfshirë në hartimin e tekstit. Nuk i di kapacitetet ligjore deri në fund të Kuvendit të Komunës, mirëpo ndoshta ka të drejtë që dikë ta shpall person "Non Grata". Sidoqoftë, po e bëjmë një teskt dhe po e prezentojmë. Faleminderit shumë! Respekt për kontributin, Sefë dhe Burim.
**Kryesuesi:** Pas diskutimeve të shumta, si pika shtesë i vendosim në votim: Deklaratën dhe Informatën e K.R.U Gjakova! Kush është "për"?... Kundër?... Konstatoj që unanimisht (23) votohet pikat shtesë.
**Burim Krasniqi:** Meqenëse kemi mysafirë prej K.R.U Gjakovës, konsideroj që informata e tyre të jetë menjëherë pas procesverbalit.
**Kryesuesi:** Faleminderit Burim Krasnqi! Po, është planifikuar kështu! Tani e vendosim në votim rendin e ditës komplet! Kush është "për"?... Konstatoj që unanimisht (23) votohet rendi i ditës për mbledhjet e sotme.
**Merisa Sharku:** Përshëndetje për të gjithë! Para fillimit me pika e rendit të ditës, dua ta bëj një njoftim të shkurtër. Dje, në orët e pasdites, pas një sëmundjeje ndërroi jetë profesori Nahit Vuçiterna. Pas humbjes tragjike të djalit të profesorit, familja përjetoi edhe një thyerje shpirtërore me humbjen e profesorit. Me këtë rast, koleges sonë Vlorës dhe familjes Vuçitërna u shprehim ngushëllime të sinqerta. Për kontributin e profesorit në arsim, ju ftoj për një minutë heshtje!... Nderim!

**1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:**
**Kryesuesi:** A kemi ndonjë gjë rreth procesverbalit nga mledhja e kaluar?... Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është "për"?... Konstatoj që unanimisht (23) votohet pika e parë e rendit të ditës.
**2. Informatë për furnizim me ujë të pijshëm dhe mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimeve në komunën e Rahovecit:**
**Kryetari:** Këtu është Visar Hasi - Drejtor teknik i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Gjakova" dhe Hamid Mullabazi - Udhëheqës i njësisë së Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Gjakova" në Rahovec. Mirë se keni ardhë! Bashkë me ekipin e kemi vlerësuar që është e nevojshme t'ju ftojmë zyrtarisht dhe ta informoni kuvendin e komunës, t'i japi sqarimet e nevojshme përkitazi me gjendjen e furnizimit me ujë, me planet e K.R.U Gjakovës me komunën tonë dhe me situatat që ballafaqohet qytetari ynë. Sfidat që i ka K.R.U Gjakova në raport me ujin e pijshëm dhe investimet kapitale, si dhe sfidat në raport me situatat tjera: defektet, riparimet, gropat etj... Në baza ditore ne jemi në bashkëpunim me K.R.U Gjakovën, mirëpo është e nevojshme që këta të flasim me juve duke e shpalosur informatën dhe ju gjithashtu mund të bëni pyetje.
**Visar Hasi:** Faleminderit për ftesën, kryetar! Të nderuar drejtorë komunalë, asambleistë dhe të gjithë të pranishmit në sallë. Në pika të shkurta do ta përmbledhi pjesën e investimeve dhe furnizimin, si dhe problemet që janë. Më detajisht për Rahovec do të flasë menaxheri Hamid Mullabazi. K.R.U Gjakova prej 1.500.000m kub, për të gjithë zonën e shërbimit me 50.000 konsumatorë për njësinë në Rahovec furnizon me 300.000m kub në muaj. Ne i kemi humbjet 62% dhe është një sfidë që jemi duke e sulmuar bashkërisht me komunën dhe inspaktorët komunalë. Kryetar, të falënderoj shumë për përkrahjen në takimin e fundit që e kemi pasur. Kemi telashe me infrastrukturë dhe me terrenin që është në disnivele të larta, sido që të jetë K.R.U-ja vazhdimisht ka bërë investime: E kemi projektin e madh që përfshin Zoqishtin, Hoçën e Madhe, Opterushën (zona ekonomike), është projekt 950.000€, 500.000 janë investim nga ministria, 200.000 komuna dhe pjesën tjetër e ka K.R.U-ja. Procesi i punës po vazhdon dhe projekti është gati të realizohet. Në tri rrugë të Rahovecit kemi bërë marrëveshje mirëkuptimi, por janë ndërprerë punimet, por te rruga "Gëzim Hamza" kanë përfunduar të gjitha me participim të komunës, të cilën e falënderojmë. Në Ratkoc, në drejtim të Bratotinit kemi bërë një investim 60.000€ dhe kanë përfunduar punimet. Kjo marrëveshje ka qenë 30.000 komuna, 30.000 K.R.U-ja. Jemi në përfundim të investimit në fshatin Pataqan i Poshtëm dhe i Epërm, investim vetanak i K.R.U-së me 134.000€ dhe jemi në fazën finale. Jemi në pritje të investimit në fshatin Brestoc 90.000€ dhe me kërkesë të komunës, jemi në finalizim të 9 rrugëve të Rahovecit, me kosto 85.000€. Të gjitha këto e kapin shifrën 459.000€ apo 50% e investimeve që i bën K.R.U-ja në krejt zonën e shërbimit. Sa i përket ujërave të ndotura, në këtë aspekt jemi pak më të hendikepuar, sepse rrjeti në disa vende është i stërvjetruar. Këtu kemi intervenuar në disa zona: Gexhë, Rahovec, Drenoc. Gjithmonë, këto probleme të kanalizimeve vijnë nga mungesa e vetëdijes së qytetarëve, që në gypa të kanalizimeve hedhin mbeturina inerte, sepse tutje faji i gjuhet K.R.U-së dhe komunës. Sikur të ishte një vetëdijësim më i madh që në kanalizime të mos gjuhen gjësende të tilla, atëherë gjendja do të ishte më e mirë dhe më relaksuese. Sido që të jetë, ne jemi në shërbim të qytetarëve.
**Hamid Mullabazi:** I nderuar kryetar i komunës, drejtorë dhe asambleistë! Si udhëheqës i njësisë operative i K.R.U Gjakovës në Rahovec, do të flas më shumë rreth informatave për furnizim me ujë të pijshëm në komunën e Rahovecit. Furnizimi me ujë të pijshëm po realizohet në mënyrë të rregullt në pjesën më të madhe të zonës urbane dhe pjesërisht në zonat rurale. Aktualisht sistemi funksionon me kapacitet optimal, ndërkohë që monitorohet vazhdimisht përmes ekipeve në terren. Gjatë sezonës verore është evidentuar rënia e sasisë së ujit në disa burime dhe kemi rritje të kërkesës së konsumatorëve për ujë. Kjo gjendje ka sjell ndërprerje të përkohëshme në disa lokalitete, që janë mbi pozitën gjeografike ku janë të vendosura bazenet e furnizimit me ujë. Nga ora 23:00 deri në 06:00 në disa fshatra dhe në zonën e parë të Rahovecit është vendosur të ketë reduktime, shkaku i ruajtjes së balancit në shpërndarje të ujit gjatë ditës. Gjatë muajit qershor komuna e Rahovecit është furnizuar me rreth 300.000 kubikë dhe janë faturuar 100.000, pra, 200.000 është humbja e ujit. Ky është keqpërdorim i madh i ujit dhe kërkojmë një ndërgjegjësim të qytetarëve. Në këtë

gjendje, uji duhet të përdoret vetëm për gjërat esenciale dhe jo për vaditjen e oborreve dhe bahçeve. Në rast të paraqitjes së ndonjë defekti emergjent, ekipet tona janë në gatishmëri të plotë. Fshatrat që për momentin i kemi me reduktime janë: Nushpallë, Pataqan, Drenoc, Opterusha dhe zona 1 e Rahovecit.

**Kryetari:** Këta, të dytë janë djem të heronjve, Hamidi dhe Visari. E vlerësoj përkushtimin individual të tyre dhe duhet të sqaroj disa gjëra që lidhen përkitazi me gropat, riparimet, kthimin në gjendjen e mëparshme, lista e keqpërdoruesëve. Komuna e Rahovecit, në shumicën e projekteve kapitale participon me 49% me K.R.U Gjakovën, sepse ekziston një marrëveshje mirëkuptimi. Në kuadër të marrëveshjes sipas ligjit për ndërmarrje publike, mirëmbajtja e kanalizimeve i takon këtyre. Këta kanë për detyrë t'i zhbllokojnë, t'i ndërrojnë gypat dhe ta bëjnë mirëmbajtjen në tërësi rrjetin e kanalizimit, sepse sipas ligjit ne faturohemi edhe për mirëmbajtje. Cilat planet e juaja që për këto ditë të nxehta me një numër të madh të bashkatdhetarëve, sa i përket ujit dhe reduktimeve, si dhe ku dhe kur do të kemi reduktime? Ndoshta do të ketë pyetje të tilla, sepse unë do t'ju kursej.

**Burim Krasniqi:** Faleminderit kryesues! Ju falënderoj për informatën! Kur diskutohet për kompaninë, diskutojmë për të, pra, nuk kemi të bëjmë me emra të përveçëm, as me menaxhmentin e degës në Rahovec, as me drejtorin teknik, por vetëm me situatën në përgjithësi. I kam disa kërkesa, shqetësime ose sqarime. Projekti që po finalizohet në drejtim të Opterushës, a do të ketë rezervuar të ri, apo do të furnizohet prej rezervuarëve të njëjtë? Nëse furnizohet prej rezervuarëve të njëjtë dhe që këtë rezervuarë nuk arrijnë t'i plotësojnë kapacitetet e qytetit, cila do të jetë situata me Opterushën? Nuk pres të ketë zgidhje, as me zonën industriale, as me Opterushën. Po flas se jam inxhinier me profesion, nuk po flas veç "me të dëgjuar"! Nuk jam i hidros, por e kuptoj situatën. E dyta, sfidë e e madhe e verës për furnizim me ujë është në Hoçë të Vogël dhe Brestoc, sepse këta furnizohen prej drejtimit të Krushës me presionin që vjen prej burimit. Do të thotë që nuk kanë rezervuar akumulues ku pompohet dhe e fiton presionin e ujit. Ai investim prej 90.000€ në Brestoc, a bën zgjidhje? Unë nuk besoj! Nuk dua të përzihem në punët e juaja, por mendoj që kur bëhen investimet, duhet të jenë të planifikuara qartë për zgjidhje afatgjate dhe unë kam pritur që do të ndërtohen rezervuare mbi Rahovec, që do ta lehtësonin furnizimin me ujë për Rahovecin, Opterushën, Zoqishtin, Hoçën e Madhe dhe Brestocin - Hoçën e Vogël, sepse është e nevojshme që këto dy fshatrat e fundit të rilidhen, sepse prej Krushës nuk mund të bëni zgjidhje tjetër për shkak të disnivelit. Te çështja e furnizimit: faktikisht e pashë që Komuna e Rahovecit e ka nënshkruar një kontratë për riparimin e rrugës Rahovec - Polluzhë dhe ky është një lajm i mirë që po bëhet ky investim pas 20 viteve. Ajo pjesë është ndërtuar nga ish kryeshefi Ibrahim Kryeziu, në bashkëfinancim me qytetarët e asaj zone dhe më aty nuk ka pasur investime të tjera. E kam një pyetje: Drenoci dhe Senoci kanë problem me ujë të pijes. Situata aktuale nuk i bën zgjidhje, në bazë të diskutimeve që i kam pasur dikur me kryeshefin, aty do të ketë investime. Sa është e harmonizuar marrëveshja për asfaltim me investimet e juaja? A do ta prejmë asfaltin pas 6 muajve ose pas një viti? Ne mund të kemi mospajtime të ndryshme, por investimet në infrastrukturë rrugore, me investimet në sistem të ujit të pijes duhet të jenë plotësisht të harmonizuara dhe jo komuna të shtrojë asfalt, ndërsa ndërmarrja ta prejë asfaltin. E rekomandoj drejtorin e Shërbimeve Publike që këtë punë ta ketë në konsideratë dhe të trajtohet drejtë me K.R.U Gjakovën. Nuk konsideroj që një asfalt shtrohet që mos të prishet për 6 muaj, por për më gjatë. Te çështja e humbjeve: Gjatë verës rritet konsumi sa i përket pijes dhe dushit, por jo në atë nivel që të rritet 50/60% sa që mos të ketë mundësi për furnizim. Logjika e thotë që nuk janë rritje të inkasuara, por janë rritje të keqpërdorura (janë lidhje jashtë orës). Unë nuk mendoj që dikush duhet të ketë pasoja në ujë, veç pse dikujt tjetër iu ka "tekë" të ujitë diçka. Këto gjëra nuk duhet t'i amnistoni, duhet të veproni! Ekziston një bazë ligjore, ku secilin e dërgon në përgjegjësi. Logjikisht jemi në rregull me periudhën e reduktimit, por njerëzit kanë edhe dasma e ahengje brenda familjes, që automatikisht ballafaqohen me këtë sfidë. Më la përshtypje që the për çështjen e mirëmbajtjes së kanalizimeve, që rrjeti i stërvjetruar është sfidë. Rahoveci nuk ka rrjet të stërvjetruar të kanalizimeve dhe nuk besoj që ka kanalizim që është vendosur para luftës, krejt janë pas luftës. Në rrugën "Xhelal Hajda – Toni" në 2004 është vendosur kanalizimi dhe në shumicën e lagjeve gradualisht ka pasur ndërrim të rrjetit të kanalizimit. Jam i bindur që rrjeti i stërvjetruar nuk është faktor i pamundësisë së mirëmbajtjes së kanalizimeve. E njoh mirë sitatën, sepse jam pjesë e proceseve. Në 2003 kam punuar si inspektor

brenda komunës dhe më ka ra t'i përcjelli disa zhvillime. Mos e merrni personale, por parimore dhe të angazhohemi të gjithë bashkë, për t'i dhënë zgidhje çështjes së furnizimit me ujë. Mbi të gjitha, të koordinohet mirë investimet që pas pak kohë mos të ketë nevojë për ndonjë ndërhyrje për riparim. Nëse mund ta kemi një informatë rreth zgjerimit të rrjetit të ujit në drejtim të Opterushës, a do të ketë rezervuar të ri dhe a ekziston mundësia që Brestoci dhe Hoça të lidhen me këtë rezervuar?

**Defrim Kafexhiu:** Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar, drejtorë, kolegë anëtarë, drejtori i Njësisë K.R.U Gjakova – Rahovec, Hamid Mullabazi, i nderuar Visar Hasi dhe ju të pranishëm. Faleminderit që keni ardhur të na informoni për gjendjen e ujit të pijshëm për banorët e komunës së Rahovecit, për sfidat dhe për pritshmëritë e qytetarëve në përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm. Unë nuk jam inxhinier si Burimi, jam politolog me profesion dhe nuk marr vesh shumë në procesin e furnizimit me ujë të pijshëm. Në sezonë të verës nëse ka reduktime, besoj që është shumë normale shkaku i temperaturave dhe stinës, që logjikisht ka më pak ujë dhe furnizimi është normale të jetë më i reduktuar. Një gjë që më la përshtypje është puna e shfrytëzimit të ujit jashtëligjshëm dhe besoj që është shkaktari më i madh i furnizimit me ujë pastaj. Besoj që ju duhet të jeni të pakompromis në ata që e keqpërdorin ujin jashtëligjshëm. Të vetmen kritikë që e kam ndaj K.R.U Gjakovës është për infrastrukturën rrugore, në të cilën patjetër duhet të ketë ndërhyrje qoftë për kyçje, apo rregullime nga ana e K.R.U Gjakovës. Pas ndërhyrjes, sipas zyrtarëve të komunës, rregullimi i asaj është në kompetencë të K.R.U Gjakovës. Na kemi zyrtarë publikë këtu, zyrtarë të Aleancës dhe anëtarë të kuvendit që thonë: problemi më i madh që po shkatërrohet infrastruktura është prej K.R.U Gjakovës. Ndërhyrje do të ketë gjithmonë dhe të vetmen kritikë e kam te pjesë që punimet të bëhet siç duhet dhe rruga të rikthehet në gjendjen e mëparshme. Si qëndron bashkëpunimi në mes komunës dhe K.R.U Gjakovës? Shpesh herë kemi qenë të vetëdijshëm që ekzekutivi po e gjuan fajin te K.R.U Gjakova - K.R.U Gjakova te ekzekutivi! Meqenëse jemi këtu bashkë, kam qejf ta di se kompetencë e kujt është dhe pse nuk rregullohet ashtu siç duhet, si dhe kur nuk rregullohet siç duhet, kush duhet t'i qëndrojë gati asaj?

**Kryetari:** Çështja e furnizimit me ujë është çështje edhe e subjekteve politike, sepse kanë mandat dhe janë të zgjedhur, por, ne nuk e lidhim këtë gjë me subjektet politke, sepse ka shumë njerëz që nuk mund të jenë anëtarë të subjekteve politike, fëmijët, të miturit etj... E vërteta është që kemi një marrëveshje mirëkuptimi. Nuk jam vetëm unë që kam nënshkruar, ka qenë edhe Qazim Qeska (ndjesë pastë), Idriz Vehapi dhe kam vazhduar unë, si dhe vazhdojmë ta kemi këtë marrëveshje, e cila rishikohet dhe gjithmonë ka elemente të reja. Marrëveshjet e tilla të mirëkuptimit janë në funksion të mobilizimit dhe mirëkuptimit të operacionalizimit të veprimeve të ndryshme dhe në çdo kontratë ai që e kryen një punë, ka për detyra ta rikthejë gjendjen ashtu siç ka qenë. Ne si komunë i kemi disa lehtësira për K.R.U Gjakovën që këta të ndërhyjnë shpejt dhe ta rregullojnë problemin sa më shpejt që është e mundur, si dhe ta kthejnë në gjendjen e mëparshme. Nëse e shikojmë ligjërisht, atëherë është dashur t'i ndjekim disa procedura, e atje ai tjetri nuk ka kohë, sepse kërkon ujë. Te kualiteti i punimeve: Ne si komunë i kemi pakënaqësitë tona, gjithashtu qytetarët i kanë vërejtjet e tyre. Ne jemi në kontakt me këta çdo herë dhe i ftojmë në takime të zakonshme dhe të jashtëzakonshme. Pyetja ime për K.R.U Gjakovën ka qenë rreth asaj që tani ka ujë më shumë, pra, prodhohet më shumë dhe gjithashtu ka reduktime më shumë?! Si është e mundur? Komuna jonë në kohën e Idriz Vehapit dhe në kohën time ka investuar në ndërtimin e fabrikës së ujit. Një argument që e japin këta janë humbjet dhe hypat e vjetër. Argument shumë i rëndësishëm janë keqpërdorimet. Prej para luftës, ndoshta edhe pas luftës ka njerëz që e kanë lidhur ilegalisht, të cilënt ne nuk i dimë. Unë ju ftoj që të na jepni listën dhe ne me inspektorët tanë do t'ju ndihmojmë. Ka keqpërdorime në qytet në Pataqan të Poshtëm dhe në Opterushë, ku disa prej tyre janë zbuluar. Mirëpo, ende ka listë të gjatë të keqpërdorueseve, të cilët keqpërdorin ujin. Te gropat, i kemi vërejtjet tona dhe i kemi thënë publikisht, por ne nuk fajësojmë. Problemi është që këta nuk kanë kontratë për riparimin e gropave, por pyetni Visarin se sa dënime keni marrë prej Komunës së Rahovecit! Pyetni Visarin që edhe kur i kanë marrë dënimet, rezultati ka munguar përsëri, sepse ka kohë që nuk kanë kompani të tillë. Kam pasur qejf që sot të jetë këtu edhe kryeshefi i K.R.U Gjakova, Hasan Krasniqin, i cili është politik, ndërsa ky është profesional. Ai ka qenë i ftuar për të na dhënë përgjigjet rreth punëve që

duhet të kryhen dhe që varen prej tij dhe jo prej ekipit. Njeri më merak për "rrafsh" e për mospunë se sa kryeshefi aktual, nuk besoj që ka. Nuk kam asgjë personale me të, por në kuptimin e menaxhimit nuk është adekuat. Për moment adresë e kemi Visarin, si dhe Hamidin, i cili po bën një punë të përkushtuar, por gjithashtu mendoj që kryeshefi duhet të jetë më në nivel të detyrës, sepse ka kompetenca bukur të forta. Kontratat që i ka K.RU. nuk i lidh Komuna e Rahovecit, por i lidh K.R.U-ja, sepse marrëveshja thotë ata që e kanë 1% më shumë, ata i zhvillojnë procedurat dhe në fund të gjitha regjistrohet si asete të K.R.U Gjakovës.
**Sejfullah Sejfullahu:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje për drejtorët, djemtë e heronjve. Unë jam nga Krusha e madhe. Rreth furnizimit me ujë nuk kam ndonjë vëretje të veçantë, mendoj që gjendja është korrekte, përveç problemeve të theksuara me kanalizim. Mendoj që në këtë aspektu duhet të jeni pak më vigjilent, sepse ne kemi probleme dhe hendikep e kemi krejt kanalizimin. Sa herë kemi të reshura, uji futet në shumë shtëpi dhe kanalizimi del jashtë. Me sarkazmë: Nëse do të investonim në kanalizime, sa kemi investuar në digjitalizim, nuk do të kishim nevojë të "fëlliqemi" nëpër rrjete sociale. Mendoj që, deri sa komuna e bën zgjidhjen për rregullimin e kanalizimit, është mirë të gjejmë forma të tjera, sepse problemet janë të theksuara.
**Drilon Mustafa:** Faleminderit kryesues! Të nderuar asambleistë, i nderuar Hamid Mullabazi dhe Visar Hasi. Unë jam nga fshati Guri i Kuq dhe aty jemi në rregull me ujë. E kemi sistemin me pompim dhe nuk kemi vërejtje. Po flas për një problem në fshatin Kramovik, në të cilin kemi probleme me kanalizim qe 6 muaj. Kanalizimi shkarkohet në rrugën regjionale Kramovik-Xërxë dhe besoj që kur të kaloni andej nuk mund t'i ikni asaj lagështie, edhe nëse është 40 gradë, lagështia është mbi asfalt. Më 10 qershor e kam bërë një aksion simbolik rreth gropave në rrugë. Në zyrë i printova 15 fleta me një mbishkrim dhe mendova ta mbulolojë krejt komunën e Rahovecit. Prej Kramovikut, kur erdha në Gexhë fletët m'u hargjuan. Do të thotë, prej Kramovikut deri në Gexhë janë 15 ndërhyrje që nuk i keni kthyer në gjendjen e mëparshme. Çdo qytetar, për një kubin ujë të shpenzuar paguan 17 centë për mirëmbajtje. Nëse kalkulojmë, i bie që në secilin fshat mirëmbajtja të jetë mbi 2000€. Mendoj që në kanalizim nuk investohet asgjë dhe ka vite që ju i thithni këto mjete, të cilat nuk na kthehen.
**Merisa Sharku:** Faleminderit për informatën prej udhëheqësve. Shqetësues më duket fakti i statistikave të keqpërdorimit. Mendoj që K.R.U Gjakova, në bashkëpunim me Drejtorinë e Inspektoratit duhet të bëjë më shumë rreth kësaj çështjeje. Gjendja me furnizim do të ishte shumë më stabile, nëse nuk do të ndodhte ky keqpërdorim kaq i madh.
**Bejtullah Deliu:** Faleminderit i nderuar kryesues! I nderuar kryetar, zëvendëskryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë, media. Faleminderit drejtor teknik dhe po ashtu përgjegjësi i K.R.U Gjakovës në Rahovec. Po më vjen mirë që keni marrë hapa të tilla për ballafaqim direkt, edhe pse po e shohim që me kryetarin keni takime. Këtu presim prej juve të na tregoni nëse keni ndonjë plan konkret për vërejtjet e cekura deri tani dhe se si do ta zbatoni? Unë dua ta shtroj edhe një çështje këtu: Pjesa teknike mund të rregullohet ose të vonohet dhe me sa e di unë gypat janë bukur të vjetruar në qytet e në fshat. A e keni ndonjë analizë se sa janë gypat e vjetër dhe a guxojnë që kaq vite të kalojnë dhe ne të vazhdojmë të pijmë ujë nga ata përques. Gjithashtu, nëse janë gypat e asbestit, unë e di që asbesti është kancerogjen dhe nuk guxon të qëndrojë. Sidomos asbesti dhe është urgjente të intervenohet. Jo rastësisht jemi ndër komunat më me shumë të sëmurë nga veshkët dhe kjo mund të jetë një shkak i kësaj. Kam informacione që Rahovecit ka shumë pacientë që shkojnë në dializë bashkë me Gjakovën. Rasisht kam ardhur te kjo informatë dhe po aludohet që çështja është te gypat e asbestit dhe finalizimi është kur qytetari pin ujë. Kemi shumë gypa të vjetruar dhe ndoshta është e udhës që të merren hapa konkretë në këtë drejtim, sepse shëndeti është parësor. Komuna, së bashku me K.R.U Radoniqin dhe me qeverisjen qëndore, të kërkojë që gradualisht në çdo fshat e çdo lagje të bëhet përmirësimi i këtyre gypave. Nëse e krahasojmë punën e gropave që nuk kryhen dhe e lëmë anash shëndetin, atëherë besoj që jemi të orientuar gabimisht.
**Fahrije Lushi:** I nderuar kryesues, kryetar, të pranishëm! Më gëzon fakti që sot i kemi dy përfaqësues nga K.R.U Gjakova, ani pse kryetari tha që do të ishte mirë ta kishim edhe kryeshefin që t'i njohim rrethanat më mirë. Pajtohem plotësisht me të gjithë parafolësit e mi. E kam ngritur shpesh këtë çështje në kuvend komunal dhe sot kërkoj një përgjigje më të drejtëpërdrejtë: këto dëmtime të rrugëve që janë bërë, janë konkretisht në fshatin Ratkoc, prej nga vij

unë. Aty janë dy dëmtime, përkatësisht para pronës sime dhe shkaktojnë jorrallë incidente. Kërkoj që të na tregoni se në kompetencë të kujt është rregullimi i këtyre dëmtimeve të rrugës, që përkatësisht vijnë nga K.R.U Gjakova.
**Eqrem Spahiu:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë, si dhe për të dy udhëheqësit e K.R.U Gjakovës. Unë kam një kërkesë: pse në Opterushë ka reduktime, kur uji te burimi është i bollshëm?
**Defrim Kafexhiu:** Harrova të plotësoj edhe diçka! Driloni që e përmendi aksionin simbolik. Këtu po e shoh që nuk janë të gjitha dëmtimet e K.R.U Gjakovës. Besoj që, të njëjtin përgjegjësi së Driloni e kërkoi prej K.R.U Gjakovës, duhet ta kërkoj edhe prej drejtorit të Shërbimeve Publike, i cili është ulur atje lart, por nuk po i ka hije! Në fund të fundit, nuk është problemi te përgjegjësia ose kompetenca e kujt është, problemi është që qytetarët duhet ta kenë rrugën e rregulluar pas çdo ndërhyrjeje. Meqenëse aktualisht nuk paska kontratë për rregullimin e këtyre ndërhyrjeve, atëherë a mundet këtë punë ta kryejë Drejtoria e Shërbimeve Publike? Pse qytetari të vuan, çka duhet t'i interesojë qytetarit se kush e rregullon?
**Kryetari:** E kuptoj situatën plotësisht! Çështja është që asnjëherë nuk e thash që ne nuk kemi përgjegjësi, sidomos në çështjet kur janë direkt të komunës. Madje fola edhe për kombinim. Shkon e kryen punën një kompani që ne kemi kontratë dhe këta bëjnë pagesë. Ndonjëherë nuk e bëjnë as pagesën, sepse ne i kryejmë vetë, siç edhe këta e kryjnë ndonjë gropë. Nuk po flas për politikë, por atë veprim që e ka bë Driloni, nuk ka lidhje me komunë sepse ajo rrugë është rrugë rajonale. E vlerësoj veprimin dhe përkushtimin individual të Visarit dhe Hamidit, bile shpesh i thërras edhe në gjysmë të natës. Neve na intereson të kemi ujë të pijshëm, mos të kemi ujëra të zeza që qarkullojnë në rrugë dhe të kemi veprime konkrete që defekti që riparohet të rikthehet siç ka qenë. Këto punë përpiqemi t'i bëjmë në baza ditore dhe mesiguri këta i kanë disa përgjigje për sfidat që ne i adresojmë çdo ditë.
**Visar Hasi:** Faleminderit kryesues! Më kanë bërë pyetje shumë, nëse e harroj ndonjë e bëjmë replikën. Kryetar, fillimisht do të përgjigjem juve. Ne kemi planet të investimeve për zonën 1 të Rahovecit, pikërisht lidhet te pyetja e z. Burim Krasniqi, që ndërlidhet me zonën 2, aty ku janë duke u zhvilluar punimet për Hoçë dhe Opterushë. Do të bëhet një rezervuar te ETC-ja, deri sa ta zgjidhim çështjen pronësore-juridike. Është një kosto 600.000€, por nuk kontestohet kjo, sepse do të gjejmë fonde. Me këtë gjë, pjesa e zonës 2 do të shkëputet prej zonës 1 dhe do të evitohen shumë probleme. Prej këtu do të furnizohet pjesa e zonës deri në Opterushë – zonë ekonomike.
**Burim Krasniqi:** Lartësia mbidetare te ETC-ja, a është e mjaftueshme ta furnizojë me ujë edhe pjesën tjetër që është në lagjen e nëntranzitit të Rahovecit? Presioni i ujit a arrin deri atje?
**Visar Hasi:** Z. Krasniqi, ky projekt daton prej 2018-tës dhe është bërë nga inxhinierët që tanimë janë në pension: Faruk Pollosha dhe Bilall Karagullami, të cilët kanë punuar 40 vjet. Ky është projekt i analizuar në detal dhe nuk do të ishim futur në investime te "Lot 2" pa e bërë këtë analizë. Qëllimi për të çuar ujë në Zoqisht, Hoçë, Opterushë ka qenë që t'i largojmë ujërat e burimeve dhe ta çojmë ujin e fabrikës. I njëjti qëllim është edhe në Senoc dhe në Drenoc. Tani dua të ndëlidhem te pyetja juaj z. Krasniqi dhe te kryetari: kur kanë kaluar 2 projektet për Senoc dhe Drenoc në ministri, me kërkesë të komunës dhe të K.R.U-së, gjithashtu edhe atje ka burime që duhet të hiqen, që ka probleme dhe që uji nuk është si i fabrikës. Prej ministrisë për Senoc dhe Drenoc është ndarë një shumë e vogël dhe kryeshefi i K.R.U-së ka vendosur që fondet për Senoc dhe Drenoc të kalojnë në projektin që është duke u zhvilluar tani, që të plotësohet dhe të përfundohet më lehtë. Plan tjetër është Senoci dhe Drenoci, projekt ky që kushton 950.000. Uji do të merret prej fshatit Polluzhë dhe nuk ka nevojë për depërtime të asfaltit, por projekti do të shkojë nëpër ara. Projekti tjetër është Opterushë – Hoçë, vendosja e ujëmatësve jashtë për shkak të humbjeve të mëdha. Në Opterushë, përveç humbjeve të mëdha është gjithashtu edhe rrjeti joadekuat. Vitin tjetër, K.R.U-ja do ta financon këtë projekt 180.000€. Projektin e Brestocit do ta lidhim me stacion të pompave dhe do ta shkëpusim prej Rahovecit. Te projekti i Hoçë – Opterushë, rezervuari i përparshëm i Leskës, i cili nuk është funksional, tani është sanuar dhe prej aty do të shkon uji në Leskë. Prej Leskës do të shpërndahet dhe do të formohet një stacion i pompave në Zoqisht. Për detaje të tjera, jeni të mirëseardhur te unë në zyrë. Defrim Kafexhiu bëri pyetje për lidhje ilegale: këto lidhje janë më të vërejtshme në kohën e ujitjes së tokave – Pataqan, Opterushë, Drenoc, Senoc, Pastasel etj... Pikërisht Hamidi në mënyrë të detajuar e tregoi se sa janë humbjet.

Në Opterushë i kemi gjetur tri lidhje ilegale në një degëzim të lagjes. Kjo është e papranueshme dhe ata njerëz që e keqpërdorin ujin, ia pamundësojnë të tjerëve ujin. Kryetar, kemi bërë të pamundurën që ta blejmë një instrument me detektime të thella për t'i zbuluar keqpërdorimet, por në panair në Gjermani nuk kemi gjetur. Te infrastruktura rrugore është e vërtetë që kemi probleme dhe jo rastësisht u përmendën gypat e asbestit, të cilët nuk janë kancerogjen, sepse nëse do të ishin kancerogjen deri tani do të kishim vdekur të gjithë. Unë pi ujë prej gypit të asbestit, në qendër të qytetit në Gjakovë. Gypi i asbestit është sikur një gotë e qelqit dhe mund të pëlcet nëse pak kemi atak në infrastrukturë rrugore. Ne kemi bërë studim të fizibilitetit bashkë me bankën botërore dhe projekti prej 900.000€ ka kaluar vitin e kaluar dhe kërkesë e jona ka qenë që të bëhet ndërrimi i gypave të asbestit në krejt zonën e shërbimit, në Gjakovë dhe Rahovec. Te atakimi i infrastrukturës rrugore: ne vazhdimisht punojmë me operatorë të jashtëm për sanimin e gropave. Me komunën e Rahovecit kemi probleme të mëdha, si dhe me dënime. Nuk kemi "qare" pa i ndreq rrugët. E kam biseduar me kryetarit Latifi që ta bëjnë një marrëveshje të ngjashme sikur me Gjakovë, pra ta hapim një tender të përbashkët dhe të participojmë bashkë. Kemi bazë ligjore dhe besoj që shumë shpejt kjo çështje do të zgjidhet. Gjithashtu, në një të ardhme duhet të intervenojmë në segmente të ndryshme të kanalizimit në Krushë. Në Guri të Kuq jeni mirë me ujë. Te ujërat e ndotura në Kramovik, aty është një segment i vogël dhe KEDS-i duke i vendosur shtyllat e tensionit të lartë me gjasë e ka dëmtuar terrenin. Komuna na ka dënuar 5000€ dhe ne do ta rregullojmë me nënkontraktor. Te keqpërdorimet e ujit: në sezonën e verës kemi angazhuar ekip shtesë deri në orën 21:30 që t'i kontrollojmë zonat, në të cilat mendojmë që ka keqpërdorime. Mos e vjedhni ujin, se është turp! Është turp që 1000 litra ujë t'i vjedhni për 51 centë, kur një shishe në market është 40 centë, ndërsa 1000 litra t'i biejmë është kosto z. Krasniqi, se the që je inxhinier me profesion. Përgjegjësi e gjithsecilit është që të ndikojë në vendin e tij, për të pasur shërbime më të mira, sepse keqpërdorimi ose vjedhja e ujit është vepër penale.

**Bejtullah Deliu:** Drejtor, faleminderit shumë për angazhimin. Nuk mora përgjigje konkrete për planin e juaj rreth këtyre pengesave që po bëhen në rrugë. Hiç më larg dje keni intervenuar në një rrugë dhe nuk është rikthyer në gjendjen e mëparshme. A keni plan konkret?

**Visar Hasi:** E potencova, për moment jemi pa operator që i sanon gropat. Me një operator nga Malisheva e kemi shkëputur kontratën!

**Bejtullah Deliu:** Nëse e shkëput kontratën, duhet ta dini se për sa kohë lidhet tjetra! Tjetra, më duket se pak me cinizëm e the në lidhje me punën e asbestit, që kinse në qendër të Gjakovës po e pin ujin prej asbestit dhe jemi ende gjallë, nuk paskemi vdekë. Drejtor, tani teknologjia ka ec dhe sapo hyra në chagpt, i cili e konfirmon që asbesti është kancerogjen, sidomos kur janë të dëmtuara. Paraprakisht thash që këta gypa duhet të ndërrohen, sepse ka shumë vite që janë të njëjtit. Ju u pajtuat që gypat janë shumë të vjetër, por thatë që nuk janë kancerogjen. Në fjalim e sipër para një minute, e thatë gjithashtu që në Kramovik duhet të ndërrohen gypat, sepse janë të asbestit dhe nuk bëjnë. Jeni në kontradiktë më atë që një herë e mohoni dhe tani e pohoni. A mund të na tregoni nëse gypat e vjetruar janë rrezik për qytetarët apo jo? A ka gjasë për kancer?

**Visar Hasi:** Rahovecit minimum i ka 200 doktorë specialistë. Të lutem, unë jam inxhinier. Gjithashtu është edhe Instituti i Shëndetit Publik që është në kuadët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe nëse Instituti do të thoshte që nuk bëjnë gypat e asbestit, natyrisht që nuk do të ishte shpërndarë ky rrjet!

**Bejtullah Deliu:** Ne mund të debatojmë këtu, por kjo është e konstatuar!

**Visar Hasi:** Atëherë, nëse është e konstatuar duhet ta dërgoni në instanca më të larta dhe nuk është mirë të bëni propagandë në diçka që nuk është vërtetuar.

**Bejtullah Deliu:** Këto po e thotë Organizata Botërore e Shëndetit, unë jo!

**Burim Krasniqi**: Z. Hasi, ne ndoshta mund t'ju bëjmë pyetjet të paqëlluara dhe po e zëmë që jemi shumë laikë në raport me profesionin, por konsideroj që niveli profesional jep përgjigje profesionale dhe nuk lëshohet formati i debatin në "propogandë - çpropagandë, e ndalim ujin - s'e ndalim ujin". Duhet ta marrësh me gjakftohësi dhe të përgjigjesh në ato pyetje që keni informata dhe për ato pyetje që mendon që nuk janë relevante, thoni që nuk janë relevante, duke e

dhënë ndonjë përgjigje me shkrim. Kjo formë e debatit i bie sikur ne po bëjmë politikë me K.R.U Gjakovën dhe po bëhet debati më shumë politik se sa profesional. Të kërkoj mirëkuptim, sepse jo ju, por askush nuk lejohet të vij në asamble komunale dhe të duket sikur ka tendencë ofendimin e asambleistëve.

**Visar Hasi:** Të lutem, mos më keqkuptoni, nuk është cinizëm, sepse e përmenda që nuk janë kancerogjen – nuk është vërtetuar. Nuk e ofendoj askënd, përkundrazi, por gjithashtu nuk e lejoj që kompaninë ta ulni poshtë. Sa i përket çështjes politike, më besoni që nuk e di se të cilës parti jeni.

**Lirigzon Kastrati:** Faleminderit kryesues! Faleminderit drejtor, që keni ardhë të na informoni për gjendjen e ujit. Një tem e rëndësishme, sepse edhe ne si përfaqësues kemi kërkesa të vazhdueshme nga qytetarët. Çdo kërkesë në këtë rast për ujë të pijshëm, fillimisht adresohet tek ne dhe pastaj ne duhet të diskutojmë këtu, me ekzekutivin dhe në fund ta dimë nëse kanë diskutuar me juve si drejtor operacional. Vitin e kaluar në fshatin Hoçë e Vogël i kemi pasur dy plasaritje të gypit të ujit të pijshëm dhe gati 24 orë ka qenë intervenimi për ndalje. Rekomandoj që të gjitha plasaritjet që ndodhin të intervenohen në kohë të caktuar dhe shpejt, sepse konsiderohen goxha humbje të mëdha për kompaninë që ju punoni.

**Visar Hasi:** I nderuar, për 24 orë të mos intervenojë K.R.U Gjakova, ka mundur të jetë vetëm ndonjë lagje e vogël, përndryshe shumicën e rasteve intervenojmë pasdite. Do t'i ngrisim këto çështje. Ka vend për përmirësim. Numri im është në ueb-faqe dhe nëse ka këso raste më shkruaj, të paktën mund të them që sonte ndale ventilin dhe në mëngjes të internevojmë.

**Kryetari:** Faleminderit për kontributin e anëtarëve të kuvendit dhe faleminderit për përgjigjet dhe informacionet. Besoj që duhet të rritet përkushtimi dhe serioziteti i angazhimit për furnizim me ujë të pijshëm. Sisterna e madhe duhet të riparohet, sepse po vërtetohet që na duhet shumë. Ne jemi bashkë në përpjekjen kundër keqpërdoruesëve të ujit dhe nëse keni ndonjë kërkesë në mungesë të resurseve që merren me kontroll, do t'ju ofrojmë në dispozicion inspektorët tanë. Gjithashtu mendojmë që të uleni me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe t'i mbyllni disa gropa që janë qe 300 vjet (figurative), sepse nuk mund ta presim një operator që potencialisht nesër mund të lidhni kontratë. E di që janë duke i ndërruar gypat e asbestit, në qytet dhe në plot vende, sepse është standard i ri. Nuk janë të paraparë gypat e asbestit, por vendosen gypa të plastikës me kualitet. Ajo që më bëri përshtypje te Senoci dhe Drenoci. Projekti është futur në kornizë afatmesme të shpenzimeve nga Ministria e Ekonomisë, me presionin tonë dhe të K.R.U Gjakovës dhe kryeshefi e ka hequr, kështu e lexova te Visari. Ky projekt nuk është dashur të hiqet. Pra, asnjë punë nuk është varur prej neve. E falënderoj publikisht Visar Korenicën që ka dhënë kontribut në këtë projekt dhe më pas është hequr nga ministria. Për fund, dua t'ju falënderoj shumë për kontributin Hamid dhe Visar. E rëndësishme është që po vazhdon procesi i ndërrimit të gypave të asbestit, sepse K.R.U-në e kemi dënuar dhe na ka ardhur keq për këtë, por qëllimi ynë është që t'i fusim në funksion edhe pak më shumë që t'i kryejnë punën e veta.

**Bejtullah Deliu:** Moralisht dua ta jap edhe një sqarim, sepse më duket që thatë që nuk ka nevojë për panikë. Nuk jam person adekuat dhe nuk dua ta fus në panikë popullatën, por në bazë të leximeve e potencova që asbesti është kancerogjen. Dua ta citoj vetëm një paragraf të kësaj në pyetjen e chatgpt-së, se a është asbesti kancerogjen?... "Po, asbesti është kancerogjen. OBSH-ja dhe Agjencia Ndërkombëtare për Kërkime mbi Kancerin e kanë klasifikuar asbestin si kancerogjen numër 1. Kjo do të thotë që ka prova të qarta që asbesti shkakton kancer tek njerëzit. Për të qenë sa më korrekt me drejtori, është e vërtetë që gypat qenkan më pak kancerogjen, mirëpo nuk nuk eliminohet dyshimi, se nëse janë të vjetër kanceri është evident edhe nëpër ato gypa. Dua ta lexoj edhe këtë pjesë se ku ka rrezik më të lartë te gypat: nëse gypat janë të vjetër dhe të degraduar, nëse uji është shumë me acid - ose gërryes, nëse ujësjellësi ka presion të lart që mund ta dëmtojë strukturën e gypit dhe kjo do të thotë që është kancerogjen! Pra, nëse ju jeni duke u orientuar në projekte të mëdha, mos vallë është kjo më primare? Këtu e pata, nëse është shëndeti më primar në krahasim me disa investime që bëhen?! Kaq, nuk kam aluduar, e as nuk kam dashur ta ofendoj askënd. K.R.U Gjakova është për lëvdatë, sepse dita e ditës janë në përmirësim dhe me ardhjen e Hamidit nuk kam asnjë dyshim.

**Kryetari:** E ftoj K.R.U Gjakovën që ta rrisë përkushtimin në punë, sidomos në këto ditë që po vinë, sepse është e kuptueshme që numri i njerëzve po rritet. Ju saktësoj që gypa të asbestit nuk vendosen më, sepse tani kërkohen standarte të tjera. Ju falënderoj dhe ju ftoj për nga një kafe, sepse jemi shqiptarë dhe mikpritës. Për fund, "shyqyr" që chatgpt-në nuk e kam të instaluar, sepse "po t'kallke" për të gjitha gjërat!

**Kryesuesi:** Faleminderit kryetar! Të nderuar kuvendarë, e përfunduam pikën e dytë dhe tani shkojmë me një pauzë njëorëshe...

**Kryetari:** Të nderuar anëtarë të kuvendit: Deklaratë kundër deklaratave fyese të Igor Popoviq-it ndaj Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në emër të qytetarëve të komunës së Rahovecit, ne, përfaqësuesit e Kuvendit Komunal, shprehim shqetësimin dhe reagimin tonë të vendosur ndaj deklaratave fyese, të papranueshme dhe tendencioze të z. Igor Popoviq, të bëra gjatë vizitës së tij në fshatin Hoçë e Madhe të Komunës së Rahovecit. Këto deklarata përbëjnë një sulm të drejtpërdrejtë ndaj historisë sonë të përbashkët dhe përpjekjeve të një populli të tërë për liri dhe dinjitet. Ato përpiqen të njollosin luftën e drejtë dhe të lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës – luftë që është themel i shtetësisë sonë dhe krenari e përjetshme e kombit tonë. Në një shtet demokratik e sovran, që ka punuar fort për paqen e përgjithshme të qytetarëve të tij pa dallime etnie, ngjyre e feje, një person me gjuhë të urrejtjes e të përçarjes, është i padëshirueshëm dhe për komunën tonë është person "non grata". Inkurajojmë bashkëqytetarët tanë të Hoçës së Madhe dhe përfaqësuesit e këtij fshati, të distancohen nga kjo gjuhë e papranueshme. Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka qenë dhe mbetet zemra e qëndresës sonë kombëtare. Ajo ishte zëri i atyre që për dekada ishin shtypur, shpresa e atyre që besonin në një të ardhme më të drejtë dhe guximi i atyre që nuk pranuan të nënshtrohen përballë padrejtësisë. Lufta e saj për liri u mbështet nga populli dhe nga aleatët tanë ndërkombëtarë sepse ishte e drejtë, e pastër dhe legjitime. Lufta e pastër e UÇK-së është themel i shtetësisë sonë dhe nuk mund të vihet në dyshim. Çdo përpjekje për të zbehur kontributin e saj është fyerje për mijëra familje që kanë dhënë më të dashurit e tyre për lirinë tonë, por edhe për çdo qytetar të ndershëm të Kosovës që beson në paqe, drejtësi dhe dinjitet. Kuvendi Komunal i Rahovecit u bën thirrje organeve përgjegjëse që t'i ndërmarrin të gjitha veprimet ligjore duke u bazuar në kushtetutën dhe të akteve ligjore të Republikës së Kosovës, të dënojnë publikisht këto deklarata të papërgjegjshme dhe të ndërmarrin veprimet e nevojshme për të mbrojtur të vërtetën historike dhe vlerat mbi të cilat është ndërtuar shteti ynë. Ne, qëndrojmë të bashkuar me respekt për të kaluarën tonë, krenarë për rrugëtimin tonë dhe të vendosur për të ndërtuar një të ardhme me paqe, mirëkuptim dhe dinjitet për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. Liria jonë ka emër. Ka histori. Ka gjak. Ka dhembje. Ajo nuk mund të preket, as të fyhet. Ashtu, si nuk mund të preket as Ushtria Çlirimtare e Kosovës, nderi dhe krenaria e kombit tonë! Lavdi të rënëve për liri! Nderime përjetësisht luftëtarëve të UÇK-së! Kuvendi Komunal i Rahovecit, Rahovec,24 korrik 2025.

**Kryesuesi:** Faleminderit kryetar! Atëherë, po e vendosim në votim! Kush është "për"?... Në mënyrë unanime votohet deklarata kundër deklaratave fyese të Igor Popoviq-it ndaj Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

**3. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve:**

**Edonë Kryeziu:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Sot dua të ndalem te një çështje shumë konkrete: asfaltimi i rrugës Rahovec-Xërxë. Që nga fillimi kam reaguar, që projekti ashtu siç ishte planifikuar nuk ishte për bujqit tanë, të cilët çdo ditë e përdorin atë rrugë me makineritë bujqësore për transportin e prodhimeve dhe për punë të ndryshme. Kërkova që projekti të rishikohet të paktën në disa pjesë kyçe, në mënyrë që rruga të ishte funksionale për bujqësinë dhe jo vetëm për veturat personale. Çfarë ndodhi? Asnjë nga këto shqetësime nuk është marrë parasysh nga komuna. Punimet vazhduar sikur zëri i qytetarëve të mos ishte aspak me rëndësi. Dje bujqit protestuan dhe me të drejtë, sepse ata janë të lodhur dhe të revoltuar nga një qeverisje që asfalton për fotografi, për fasadë zgjedhore dhe jo për nevoja reale. Pas protestës, asfaltimi vazhdoi duke treguar qartë se kjo qeverisje nuk punon për qytetarët, por për interesat e saj politike. Si përfaqësuese e qytetarëve në këtë kuvend, kërkoj urgjentisht të ndalet përkohësisht asfaltimi në segment, deri sa të bëhet një konsultim teknik me përfaqësuesit e bujqëve. Të organizohet një dëgjim publik me banorët dhe bujqit e fshatit Xërxë, për t'i përfshirë kërkesat e tyre në këtë projekt. Të kemi transparencë të plotë për koston dhe

projektin, arsyetimin teknik dhe planin afatgjatë. Rruga Rahovec – Xërxë, është arterie jetike për komunën e Rahovecit dhe nëse kjo rrugë nuk i shërben bujqëve, atëherë kujt do t'i shërben?

**Kryetari:** Faleminderit për kontributin! E paske përgatit me kujdes, shpresoj që e ke përgatit vetë. Të përgëzoj! Ka ndodh një refuzim i kërkesë së banorëve që ne e kemi dërguar. Deklaroj publikisht që unë jam "për" që bujqit të kenë qasje sa më shumë, por ka ekspertë ministria që e konsideron që aty është e rrezishme. Shefi yt politik (pa cinizëm) e din, sepse është inxhinier dhe ka punuar gjatë aty. Ata e kanë refuzuar kërkesën tonë për qasje. Protesta ka shkuar mirë, ka qenë paparalajmërim. Rruga vazhdon të asfaltohet dhe besoj që është konform kërkesave që Rahovecit të ketë rrugë 4 korsi. Ne jemi të lumtur që po arrijmë ta bëjmë me buxhet të ministries, sepse rruga është e ministrisë. Rruga do të jetë me standarte të larta dhe kompania që punon aty është profesionale. Qasja e kërkuar për bujqit, parimisht jam "për", por nuk jam ekspert e as vulën nuk e kam në dorë. Unë kam biseduar edhe me bujqit dhe ndoshta të mos bëhej kjo zhurmë mediale, Smajl Latifi është i guximshëm dhe do ta bëja qasjen. Mirëpo, zhurma mediale ndonjëherë mund t'i qartësoj situatat dhe ekspertët kanë thënë që kjo punë nuk bën, sepse fataliteti do të jetë i pashmangshëm aty. Kanë thënë që ju mund ta bëni ilegalisht, por përgjegjësia bjen direkt në ata që e bëjnë. Uroj që nesër të përfundojë asfaltimi i pjesës tjetër, sepse njëra ka përfunduar sot. Mendoj që këto situata janë angazhim i qëllimshëm për të pasur kosto në zgjedhje. Puna do të bëhet mirë dhe punës së mirë duhet t'i themi "punë e mbarë" dhe nuk ka të bëjë me zgjedhje, sepse nuk është gjithçka "zgjedhje". Unë jam i lumtur që e njëjta kompani e ka projektin deri te rrethrrotullimi në dalje të qytetit. Legjitime është kërkesa për qasje më të shpeshta, por tutje a është e ligjshme dhe e a parasheh ekspertiza? Ju lutem, ta kemi parasysh se ku jemi. Ka shqetësime dhe pakënaqësi gjithmonë dhe nuk është e vërtetë që ka mijëra bujq që kalojnë në atë rrugë, sepse e dimë saktësisht se sa bujq kalojnë andej. Bujqit kanë të drejtë legjitime, por nuk mund ta thej unë vendimin e shefit të departamentit të rrugëve, madje na kanë shkruar një fjali që "përgjegjësia kalon direkt te ju" dhe nëse ne veprojmë, atëherë ata mund të na dërgojnë edhe në prokurori.

**Lirigzon Kastrati:** Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të ekzekutivit, kolegë anëtarët të kuvendit komunal. I kam tri pyetje për ekzekutivin: Në seancën e kaluar, drejtori i Financave ka potencuar që komunës ia kanë tërhequr 2.000.000€ nga buxheti komunal. Pyetja ime: këto 2 milionë euro, a janë tërhequr për shkak të kontratës kolektive, apo për shkak të ndonjë obligimi tjetër që ka komuna ndaj operatorëve, si dhe sa janë shpenzimet përmbarimore dhe gjyqësore? Në seancën e ardhshme, kërkoj zyrtarisht të njoftohet kuvendi ose unë si asambleist. Për Drejtorinë e Administratës: Ofrimi i shërbimeve në zyrën e gjendjes civile në fshatin Hoçë e Vogël. Kjo zyre tash e mbi një vit është jashtë funksionit dhe qytetarëve iu pamundësohet kryerja e shërbimeve. Kërkoj që, sidomos në kohën kur mërgimtarët janë duke ardhur dhe kërkojnë dokumentacione, së paku aty ta gjejnë zgjidhjen dhe sa i përket zyrës pastaj të vazhdohet me procedurën e rekrutimit, mos të lejohet që zyra të mbyllet. Për Drejtorinë e Bujqësisë: Drejtor, në seancën e kaluar e kam kërkuar listën e të gjitha rrugëve fushore që komuna ka intervenuar në vitin 2024. Deri më tani nuk kam marrë përgjigje dhe është mirë të na njoftoni.

**Kryetari:** Përgjigje për pyetjet rreth financave, sot nuk është Afrim Limani, sepse e marton djalin. Ne e kemi raportin financiar, të cilin do ta prezentojë Fatmiri. Lirigzon, sipas udhëzimit të ri administrativ të gjithë punëtorët ofiqarë duhet t'i bartim këtu dhe është rekomandim. E mirëkuptoj shqetësimin që është me zyrën e vendit në Hoçë të Vogël, por udhëzimi i ri administrativ e thotë ndryshe dhe nuk guxojmë të bëjmë veprime të tjera. Luti banorët që E-Kiosk-i është në Krushë të Madhe dhe një pjesë të dokumenteve mund ta nxjerrin aty. Një E-Kiosk e kemi në Xërxë, një në Ratkoc dhe dy janë në qytet.

**Ilir Pallqa:** Faleminderit! I nderuar kryesues, kryetar, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë, të pranishëm të tjerë në sallë. Puna së fundi është rezultat i akumulimit të energjisë për tre vite paraprake. Tre vite qetësi kapitale, në fund punë dhe kryesisht asfalt. Asfaltimi i rrugëve e ka një "marifet", këtu te ne nuk e ka, sepse është bërë tani, në fund të mandatit. Po të punohej prej vitit të parë të mandatit, si në Malishevë, sot do të kishim pamje tjetër. Te ne, në rrugën "Xhelal Hajda" dhe jo vetëm, është bërë punë gjysmake, asfalti i ri – trotuarët e vjetër. Kjo gjendje tregon mungesë të seriozitetit kur vjen puna te investimet dhe ndryshimet. Mandat pas mandati, para zgjedhjeve punohet me

intensitet, jo për rregullim, por për tentim manipulimi parazgjedhor. Kjo është gabim, nëse vazhdojmë kështu në Rahovec për ndryshim vetëm do të flasim, por nuk do të kemi hiç. Meqenëse punës së mbarë duhet t'i themi "punë të mbarë"! Punë e mbarë i qoftë gjykatësit që e ka dënuar Avni Morinën dhe kështu të gjithë këta që kanë bërë krime në sektorë përkatëse, të dënohen. Nuk e di si ka mbetur puna e tij, por ne këtu nuk po e shohim. Kaq!

**Kryetari:** Shpjegimet i keni të qarta! Kemi pasur kontratë me "Benitën" më herët dhe për ta shkëputur kontatën duhet shumë procedura. Më vjen keq që dikush i kryen mandat 4 vjet dhe nuk i kupton as gjërat themelore. E kam respektuar vendimin e gjykatës, ne e respektojmë ligjin. Po ju tregoj që, djalë si Avni Morina është vështirë të gjejmë. Ne e presim vendimin e gjykatës supreme. Një gjë e di: Lumturia e dikujt nuk duhet kurrë të ndërtohet në fatkeqësinë e tjetrit, sidomos kur dihet paraprakisht siç është situata, edhe ti e din. Sa i përket gjërave të tjera, ne kemi punë edhe 4 vite të tjera këtu. Ndryshimet janë të përditshme, por dikush nuk i sheh edhe nëse ka syza nuk i sheh. Dikujt i dhemb suksesi, sepse ka njerëz të papërgjegjshëm që të githa ia falë dikujt, suksesin jo. Unë jam i lumtur që edhe një qytet po operon një kompani e fortë. Lika Company po bën "ibërcuk" të fortë, i fortë është "ibërcuku" dhe disa shenja me standarde. Ma keni lodhur veshin me zhurma se "kur po bëhen këto rrugë"? "Kur po bëhen këto rrugë"? Prandaj thuaj faleminderit, jo kryetarit, por vetëm që po realizohen mirë dhe shpejt, si dhe do të bëhen edhe 13 rrugë të tjera në qytet nga e njëjta kompani.

**Burim Krasniqi:** Po e filloj nga prezenca e drejtorëve: Drejtor, një parë tribuna të fushës së futbollit në Xërxë, kur është bërë bartja e mjeteve thonit që do t'i bëjmë, por kanë mbetur edhe disa detaje të vogla. Është dhënë fjala që do të përfundojnë, por nuk është bërë asnjë lëvizje. Drejtori i Bujqësisë apo kush e ka pasur përrockën prej Rahovecit në Fortesë? E kam një video-foto në Fortesë, të cilën e ka dërguar Artan Gashi afër shtëpisë së tij dhe është në gjendje të mjerueshme. E di që kohë pas kohe është bërë traditë shkëputja e kontratave, kur po i përfundoni çmimet e mira dhe kur po mbesin çmimet e lira – "hajde po e shkëpusim kontratën"! Ka mundur të shkojë një bager dhe ta pastrojë atë pjesë. Pas seancës foto dhe videon e postoj në facebook dhe e sheh që me të vërtetë ai segment aty është keq. Është mirë të shkoni ta shihni dhe të intervenoni aty, sepse është në gjendje të keqe. Meqë u përmendën shumë, tani janë edhe zgjedhjet dhe ju del edhe aty ndonjë votë. Kryetari nuk është, drejtori i Financave jo, Përparimi është këtu. Përrocka dhe kolektori kryesor Hoçë e Madhe – Brestoc – Hoçë e Vogël – Nagac - Krushë e Madhe. Është lidhur një kontratë dhe janë investuar mbi 500.000€, i kanë ndërtuar disa qindra metra kanalizim jofunksional, nuk është bërë asgjë dhe janë tërhequr mjetet prej ministrisë. Është rishpallë dhe keni "rreh gjyks" këtu që e keni lidhur një kontratë 1.5 milionë, por nuk po e shoh asnjë lëvizje. Kolektori kryesor dhe përrocka ka filluar në vitin 2014/2015. Kështu që, bëhuni pak më korrekt, të thoni sikur në Nagac, i ngulët 4 armatura dhe 2 lopata beton dhe thoni që po e bëjmë shtratin e lumit te shkolla dhe të mbetet ashtu. Drejtor, kërkoj një përgjigje se pse po zvarritet? Nuk ka pare? Tjetra, në raportin e auditorit për vitin 2023 janë gjetur tri kontrata, njëra rreth 3 milionë, njëra rreth 2 milionë dhe tjetra rreth 900.000€. Ku 20% të poenave iu kanë dhënë atij që e ka planin dinamik më të shpejt! Auditori e ka gjetur që, 20% të poenave iu kanë dhënë, por kontrata në fund është nënshkruar 3 vjeçare. Kjo do të thotë që, ai e ka marrë kontratën me plan dinamik, por në fund është bërë 3 vjeçare. Në tri apo katër seanca kam pyetur që të na informoni, rreth atij që ka fituar nëse ka qenë më i liri, i dyti, apo i treti. Për informim: Ndërtimi i Qendrës Rinore-Kulturore në Rahovec, kompania më e lirë ka qenë me 2.923.220€ dhe e ka fituar kompania e dytë me 2.982.585€, rreth 70.000€ më shtrenjtë se sa kompania më e lirë. 20% i poenave ia ka mundësuar që ta fitojë. Projekti tjetër: Ndërtimi i rrugëve në hapësirën për biznes dhe turizëm, e kontraktuar në 2023, kompania më e lirë ka qenë 1.872.385.80€ dhe e ka fituar kompania me 1.894.482€ dhe përsëri ka qenë e dyta, me 22.000€ më shtrenjtë se e para. Në projektin e tretë: Ndërtimi i rrugëve lokale Lot1, kompania fituese është 898.601€ si e treta më e shtrenjtë, ndërsa kompania më e lirë ka qenë me 818.692€, rreth 80.000€ më e shtrenjtë se sa më e lira! Unë e kuptoj që këto procedura i zhvillon Zyra e Prokurimit, por kryetari i komunës është nënshkrues i kontratës. Këtu direkt 20% i poenave në plan dinamik, ua ka mundësuar kompanive të marrin tendera, 2 raste kompanisë së dytë, 1 rast kompanisë së tretë. Nuk dua ta luaj rolin e hetuesit, por këtu haptas të çon në dyshimin që ka keqpërdorim. Uroj që mos të jetë ashtu, por kam pyetur në 3-4 seanca dhe kurrë nuk ma keni dhënë informatën.

Kur t'i mbledhim këto trija, janë 200.000€ më shumë se sa vlera që është dashur të nënshkruhen kontratat. 200.000€ janë diku 10% më shtrenjtë. Kërkoj që të rishikohen këto kontrata dhe të kërkohet përgjegjësi, pse ka ardhur 20% i poenave dhe pse janë nënshkruar kontratat me 20% të poenave më shumë për shkak të planit dinamik? Pse nuk është vendosur në kontratë plani dinamik dhe pse te tri kontratat nuk po na del asnjëri si më i liri?!

**Hasan Përboqi:** Përshëndetje kryesues, nënkryetar, kolegë, drejtorë. Deshta t'i bëjë disa lëvdata, sepse po na kritikojnë. E kam një kërkesë për drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve: këto ditë e kam parë që është nënshkruar një kontratë për ndërtimin e tribunave për stadiumin me bari sintetik, që është përfunduar të paktën një vit e gjysmë më herët. A mund të na informoni se çka përmban më saktë ajo kontratë dhe në planin dinamik a është e paraparë që punimet të kenë një dinamikë të shtuar, sepse po ofrohet fillimi i sezonit të ri 2025/2026. Të gjithë jemi dëshmitarë se sa ka pasur interesim për ta shikuar KF. Rahovecit përderisa ka luajtur si vendas në atë stadium. Pas përfundimit të këtyre tribunave, jam shumë i bindur që interesimi do të rritet. Për seniorët ka përfunduar sezoni dhe pritet të fillojë i riu, punët në stadium me gjeneratat e reja nuk po ndalen, operojnë disa ojq, apo disa shkolla që me të vërtetë meritojnë përkrahje dhe njëra prej përkrahjeve do të ishte ofrimi i kushteve tjera përcjellëse, në mënyrë që ky stadium të jetë sa më funskional. Për ndryshe, është kërkesë edhe në emër të grupit që dinamika e punimeve të jetë më e madhe, në mënyrë që të jemi gati para fillimit të garave futbollistike në sezonin e ri.

**Defrim Kafexhiu:** E di që jemi në një periudhë politike parazgjedhore dhe shumica këtu po bëjnë politikë, ndërsa unë po mundohet të mos bëj aq. Po mundohem ta përqoj një mesazh të sinqertë të qytetarëve të komunës së Rahovecit për nevojat që ata i kanë dhe për mënyrën si ata po trajtohen prej ekzekutivit dhe prej qeverisjes Latifi. Është një drejtor që është dënuar me burg dhe kjo nuk është gjë e vogël. Kryetari iu referuar se "a mund të gjeni djalë më të mirë"? Për mua të gjithë drejtorët që janë këtu, janë më të mirë se Avni Morina, sepse djemtë e mirë nuk shkojnë atje ku ka shkuar ai. Po gjendje po merret me shumë sportivitet, por unë besoj që si fenomen në shoqësi është shumë shqetësuese edhe pse ne kemi qenë të zëshëm kundrejt të gjithë procesit që e ka pasur drejtori në fjalë, prej momentit të ngritjes së aktakuzës dhe vazhdimisht e kemi kërkuar lirimin prej detyrës. Dyshoj që vetëm shkaku që jemi shumë afër zgjedhjeve është liruar nga detyra. Në KPF e kam pyetur nënkryetari, por pata qejf që edhe kryetari të jetë këtu që ta pyes: A ka dhënë dorëheqje a është shkarkuar, sepse si informatë për qytetarët e komunës është shumë e rëndësishme, që dikush e ka pasur një funksion publik për dy mandate (pa dy muaj), duhet ta dimë a është shkarkuar për shkak të vendimit të gjykatës, apo ka dhënë dorëheqje për shkaqe shëndetësore, ose ku ta di?! Një pyetje e kam për Drejtorinë e Kulturës, dhe për Drejtorinë për Punë Inspektuese: Ne nuk jemi vend që ka fluks të madh të qytetarëve që dalin në qytet. E kemi vendin te palestra aty që po bëhet një atmosferë shumë e këndshme, sidomos me ardhjen e kurbetqarëve. Ju lus që t'i toleroni lokalet që operojnë aty, që t'i shfrytëzojnë hapësirat publike dhe që realisht nuk kanë të drejtë t'i shfryzëtojnë, por meqenëse nuk kemi ndonjë hapësirë tjetër, atëherë në këtë periudhë (muajin e mërgimtarëve) mos "i ngucni" në kuptimin e ndonjë dënimi. Te shtrimi i rrugëve: shumë mirë dhe e përgëzojmë komunën që po riasfaltohen rrugët. Ndoshta ndonjë për tyre nuk ka pasur nevojë të asfaltohet, por ndonjë tjetër po, përshkak të intervenimeve dhe dëmtimeve të shumta që i kanë pasur. Jam ithtar i asaj që kur të planifikohet investimi në rrugë të caktuar, duhet të bëhet planifikim serioz dhe të përfundohet komplet si proces që në atë rrugë të hiqet një "dert" për 20-30 vite. I kemi kabllot të energjisë elektrike mbi tokë, në qoftëse një rrugë duhet të shtrohet me asfalt të mirë, atëherë planifikimi duhet të jetë i dukur. Unë po pajtohem me Ilirin në çdo fjalë, që intensiteti i lartë i punëve para zgjedhjeve nuk mund të jetë "okej", sepse ato punë kanë mundur të kryhen edhe më herët, ose të paktën kanë mundur të planifikohen më herët. Pse nuk po kryhet komplet infrastruktura dhe kur shtrohet asfalti mos të ketë nevojë të ndërhyjmë përsëri pas 2-3 viteve?! Prej lagjes time, përgjatë krejt këtij mandati e kam pasur një kërkesë të vazhdueshme: E di që edhe ekzekutivi ka vullnet dhe unë përsëri kërkoj që ekzekutivi të zotohet publikisht që sa më shpejt të paktën para zgjedhjeve, t'i ndajë mjetet për shpronësim e një prone në rrugën "Vëllezërit Frashëri" për nevojat e komunitetit, për vendosjen e trafos elektrike dhe le të jetë një pjesë tjetër komunale që në të ardhme të bëhet ndonjë investim tjetër. Një pyetje e kam për drejtorin e Kadastrës, si menaxher i kontratës për rregullimin e varrezave të martirëve të luftës: ku është si proces? Para një viti

e kemi diskutuar dhe më ke thënë që është çështje ditësh rregullimi i varrezave të martirëve. Gjithashtu më ke ftuar që "nuk do të kalojë një javë, unë edhe ti do të shkojmë me një veturë të kryejmë punë", ndërsa unë ende jam duke pritur dhe nuk më thirri askush. Të lutem, të na informosh më shumë rreth kësaj çështjeve, si menaxher i kësaj kontrate.
**Sejfullah Sejfullahu:** Dua të pyes rreth punës e asaj vizite studimore? Mundësisht jo javën që vjen, sepse jam i zënë në një dasëm në Krushe.
**4. Shqyrtimi i Raportit 6 - mujor i punës së Zyrës së Prokurimit për vitin 2025:**
**Nënkryetari:** Sot janë disa mungesa të njerëzve që duhet t'i prezentojnë pikat, kështu që unë po mundohem t'i prezentoj. Mund të mos i di të gjitha, sepse Evlija nuk kam pretendime të bëhem. E keni para vetes raportin 6-mujor të punës së Zyrës së Prokurimit me të gjitha aktivitetet e saj. Janë të cekura 42 aktivitete me vlerë të parashikuar 16.577.019€. Janë nënshkruar 21 kontrata për punë furnizime dhe për shërbime me vlerë 9.147.050€. 5 aktivitete kanë përfunduar në OSHP, 3 janë anuluar dhe 13 janë në procedurë të prokurimit. Në total janë 464 urdhërblerje për pagesa të ndryshme, kryesisht që lidhen me projekte.
**Burim Krasniqi:** Kryesues, shefin e prokurimit në oborr të komunës e pashë pak para pauzës! Nuk e di pse jemi këtu! Drejtori i Financave nuk është as për raportin e drejtorit, as për raportin financiar.
**Kryesuesi:** Drejtori ka dasëm!
**Burim Krasniqi:** Përhajr i qoftë, është dashur ta përshtatë datën! E dyta, ose ta shtyejmë raportin 6-mujor financiar për seancën tjetër. Atëherë, pse të qëndrojmë në seancën, me kë të diskutojmë? Për mua është e papranueshme dhe ne si grup i asamblesitëve të LDK-së e lëshojmë seancën, nuk vazhdojmë më tutje, sepse është joseriozitet.
**Defrim Kafexhiu:** Nënkryetari e shfaqi raportin 6-mujor të punës së Zyrës së Prokurimit dhe këtu po lidhen dy kontrata: Sheshi qëndror dhe projekti i quajtur Grape City. Pse ka stagnuar projekti "Grape City"?
**Nënkryetari:** Të kërkoj falje Defrim! Dua t'i përgjigjem Burimit, që është asambleist dhe si shef i grupit të LDK-së. Burimi nuk e përcakton ku të shkojë një drejtor dhe çfarë angazhimi ka. Drejtori është i emëruar prej kryetarit të komunës dhe merrë direktiva dhe urdhëra prej kryetarit të komunës. Ky veprim i juaji është i kuptueshëm në këtë kohë fushate që ti e shfrytëzon dhe keni të drejtë legjitime. Por, për që na përcakton ti pikat e rendit të ditës dhe ku shkon një drejtor, je shumë i vogël në këtë krahasim.
**Kryesuesi:** LDK-së i dëshirojmë rrugë të mbarë! Vazhdojmë ne të tjetër që jemi këtu. Atëherë, për moment nuk kemi kuorum!
**Defrim Kafexhiu:** E përshëndes vendimin e LDK-së!
**Kryesuesi:** Meqenëse nuk ka kuorim, shkojmë me një pauzë...
**4. Shqyrtimi i Raportit të DKA-së rreth përfundimit të vitit mësimor, 2024/2025:**
**Nënkryetari:** Po e prezentoj shkurtimisht këtë raport të arsimit: Raporti është i ndarë në 4 periudha dhe janë të parapara të gjitha aktivitetet, që janë pasqyruar gjatë dy viteve kalendarike në periudhën shtator-dhjetor. Janë pasqyruar projektet, investimet kapitale, garat dhe kështu me radhë. Në KPF e kemi diskutuar që ky raport ishte i mangët në informata dhe jam pajtuar dhe çdoherë pajtohem kur ka mungesë të informatave. Nuk kemi pasur afat ta plotësojmë, sepse materiali është dorëzuar tek ju menjëherë pas përfundimit të KPF-së, mirëpo, duhet të kemi kujdes për raportin tjetër të DKA-së, i cili duhet të jetë më i plotë dhe më i qartë.
**Defrim Kafexhiu:** Në KPF për këtë raport kemi kërkuar informata shtesë dhe arsyetimi qenka që menjëherë është thirrur mbledhja e rregullt kuvendit komunal. Duhet patjetër ta jap një mendim për lirimin e sallës nga asambleistat e PDK-së. Mund të jetë politike, por në fund të fundit është mirë të trajtohemi më mirë, si kuvend komunal dhe si institucion. Seanca është bërë më herët si zakonisht që bëhet dhe ndoshta ju i keni pasur arsyet e juaja, por do të ishte më mirë që, të vonohemi 2-3 ditë dhe në bazë të pikave të rendit të ditës, prej më të rëndësishmes, sidomos Raporti i Zyrës së Prokurimit apo shqyrtimi i Raportit Financiar, që patjetër të jenë aty drejtorat, sepse janë më kredibilë të përgjigjen në pyetjet tona. Herave të tjera, ju ftoj që jeni më korrektë kundrejt neve si anëtarë të kuvendit. Sa i përket raportit të DKA-së. Ne veçse e diskutuar më herët punën e drejtorit dhe është e dhimbshme që ka qëndruar deri tani pa u shkarkuar, apo pa u liruar nga

detyra. Kryetar, është mirë ta dinë qytetarët e Rahovecit dhe ne si kuvendarë: Drejtori që është dënuar, është shkarkuar nga detyra apo ka dhënë dorëheqje? Te plotësimi i informatës dhe raporti i DKA-së, besoj që duhet të shtohet edhe përpjekja e DKA-së për përmirësimin dhe për nxitjen e mësimdhënies dhe mësimnxënies nëpër shkolla. Në këtë raport mungojnë edhe arritjet e nxënësve. Të përfshihen edhe arritjet, jo vetëm pjesëmarrja në gara. Mungesat e nxënësve dhe mungesat e mësimdhënësve, sepse mësimdhënënësit janë shërbyes publikë dhe prej tyre varen gjeneratat, e ardhmja e komunës dhe e jona në përgjithësi.

**Kryetari:** Unë nuk e komentoj informatën, sepse nënkryetari ka qenë i autorizuar. Jam me nënkryetarin kur e tha një fjali që gjithmonë ka nevojë për plotësime, për më shumë fakte, për mundësi të ndryshimit të modaliteteve të raportimit etj... Për këtë punë jemi të njohur, sepse e kemi vulën e transparencës dhe përformancës. Me kërkesë të drejtorit, unë e kam liruar. Kaq është kjo temë. Unë besoj në kualitetin e tij si njëri, vyrtytin dhe profesionalizmin e tij. Radarët e ligjit e kanë kapur dhe jemi në rregull. Brenda ekipit tim, e kam ngarkuar dikë tjetër si të autorizuar për të marrur veprime. Unë besoj në pafajësinë e tij dhe e presim vendimin e Gjykatës Supreme. Shpresoj që do të na befasoj për të mirë dhe do t'i befasojë për të keq të tjerët dhe të turpërohen, sepse e gjithë ajo që e ka bërë drejtori, në thelb është ndihmë për një njëri. E falënderoj drejtorin e DKA-së për krejt punën e bërë deri më tani. Besoj në integritetin e tij moral, profesional dhe njerëzor. Nuk dua të komentoj më shumë, sepse është vendim i gjykatës dhe unë e kam respektuar aktgjykimin.

**Defrim Kafexhiu:** Kryetar, është mirë ta korrigjosh, sepse edhe Ilirit i the më herët. Nuk turpërohem nëse del e kundërta prej shkallës së tretë – prej Gjykatës Supreme. Më vjen mirë, nëse vjen dita që unë të kërkoj falje edhe për më herët, në shkallë të pare edhe në të dytën. Shumë lëvdata i bëre Avni Morinës, por të paktën një postim publik që është liruar nga detyra. E kuptoj që jemi afër zgjedhjeve, por qytetarët duhet ta dinë, sepse mendojnë që ende është drejtor.

**Kryetari:** E kam parasysh se çka është politikë ditore, çka është politkë afatgjate dhe çka është strategji. Unë zakonisht i pranoj këshillat, por ato jo këshilla që janë me një ngarkesë emocionale, sepse jam politikan i rryer. Mirë është të m'i tregosh disa detyra edhe mua, por këto të thjeshtat i kam të qarta.

**Rasim Fazliu:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë. E di që në fillim e kemi miratuar rendin e ditës, kështu siç është. Për hir të asaj se si po shkon rrjedha, gjysma e kuvendarëve mungon etj, etj... Mungon gjithashtu efikasiteti dhe nuk mund të debatojmë siç duhet. Unë propozoj që, së paku këto dy pika që janë shumë të rëndësishme: Shqyrtimi i Raportit Financiar, janar - qershor 2025 dhe shqyrtimi i Raportit të Auditimit të auditorit të përgjithshëm të shtyhen për mbledhjen e radhës, ndërsa pikat të tjera i shqyrtojmë dhe i vazhdojmë ashtu siç janë, sepse me të vërtetë nuk ka kuptim të diskutohen këto dy pika pa prezencën e drejtorit të Financave. Nuk kam nevojë për kurrfarë sqarimi, unë e dhashë veç si propozim dhe mendoj që është shumë e logjishme dhe nuk bëhet kijameti që në mledhjen e radhës t'i diskutojmë këto dy pika.

**Kryetari:** E di që Rasimi po thotë që nuk ka nevojë për sqarim. Raporti financiar është obligativ të trajtohet tani, sepse është raport 6-mujor dhe ne kemi detyrime ndaj Ministrisë së Financave. Raportin e Auditimit nëse doni e lëmë edhe pas zgjedhjeve, sepse është raport i kualifikuar, raport shumë i mirë dhe jam shumë i lumtur për këtë raport. Duhet të provoni të jeni në nivel të përgjegjësisë. Nëse dëshirojmë të tregojmë se kush jemi, atëherë detyra jonë është të qëndrojmë në asamble. Unë ju tregova se si i ka punët drejtori Afrim Limani, mirëpo, nivel më i lartë se drejtori është nënkryetari e kryetari i komunës dhe ju besoj që e dini këtë. Uroj që ta ruajmë përkushtimin deri në fund të mandatit, sepse nuk ka lidhje kush është sot e kush është nesër.

**5. Shqyrtimi i Raportit Financiar, janar - qershor 2025:**

**Nënkryetari:** Faleminderit kryesues! Raporti 6-mujor financiar është voluminoz dhe është i përbërë me të gjitha të dhënat e nevojshme që kanë ndodhur brenda këtij 6 muajshi. Është pjesa e të hyrave, pjesa e shpenzimeve, oblifimet financiare, obligimet kontraktuale, si dhe kontratat e lidhura deri më tani. Në faqen nr.3 e keni krahasimin me vitin paraprak, kështu që në vitin 2025 për gjashtëmuaj janë realizuar 1.124.958.91€ dhe kemi një krahasim pozitiv me vitin 2024, me rritje prej 231.207€. Në faqen nr.4 kemi të paraqitura të hyrat në formë tabelare, si dhe gjobat e gjykatave dhe të trafikut. Në faqenë nr.5 janë të prezentuara kodet ekonomike buxhetore, pra, 44 kodet ekonomike si dhe krahasimi. Në faqen nr.6 e

kemi tatimin në pronë si e hyrë kryesore komunale. Të planifikuara kanë qenë 350.721 dhe të realizuara i kemi 568.061 dhe në krahasim me vitin 2024 e kemi një bilanc pozitiv prej 25.947€. Deri më 30 qershor shpenzimi i buxhetit në total është 14.453.000 (68.88%). Në faqen nr.14 e keni të paraqitur raportin e obligimeve financiare, sipas operatorëve ekonomikë. Në fund, gjithashtu i keni edhe obligimet kontraktuale që gjithsej janë 13.972.000€. Për fund, kemi likuiditet të mjaftueshëm financiar për mbulimin e obligimeve kontraktuale, në vlerë prej 15.764.782€.

**6. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Rahovecit për vitin 2024:**

**Kryetari:** Nuk është lajm i mirë që vetëm 3 komuna në Republikën e Kosovës e kanë raportin e auditimit të mirë. Kontrata kolektive pothuajse shumicën e komunave i ka penalizuar dhe kësaj radhe ne kemi shpëtuar për vitin 2024 dhe nëse është ky kriter, asnjë prej komunave të Kosovës nuk do të shpëtojë për vitin 2025, sepse vetëm sivjet thesari na ka marrë 2 milionë €. Raporti është me opinion të pamodifikuar dhe i ka 6 rekomandime, 4 rekomandime të reja dhe 2 të përsëritura. Kemi progres në zbatimin e rekomandimeve të vjetra dhe nga 9 rekomandime 2 janë të përsëritura. Ka gjetje që janë evidente të shkuara, sidomos vonesa në pagesa të faturave, si dhe ka rekomandime, por të cilat nuk kanë ndikuar në ndryshimin e kualifikimit të opinionit. Është lajm i mirë që konkurrencën e kemi të dobët dhe mirëpresim me padurim grantin e performancës. Nëse është fondi prej 8 milionë, besoj që na bjen që bukur mirë të përfitojmë. Ju ftoj që ta debatojmë këtë raport.

**7. Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, janar – qershor 2025:**

**Berat Duraku:** Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë drejtorë, të nderuar anëtarë të kuvendit. Para jush e keni materialin rreth informatës nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, janar – qershor 2025. Kjo informatë është e ndarë në dy kapituj. Pjesa e parë i përfshin aktivitetet mujore dhe pjesa e dytë ka të bëjë me investime kapitale. Në fund të raportit e keni një shtojcë me të gjitha informatat e fermerëve tanë, për secilën kulturë në komunën tonë. Në janar, aktiviteti kryesor ka qenë aplikimi i fermerëve blektorë në kuadër të ministrisë dhe kanë aplikuar fermerët për sasinë e qumështit që e prodhojnë. Në shkurt, ka qenë marrëveshja me një organizatë nga Katari, për ndërtimin e 50 serrave në bashkëfinancim me komunën e Rahovecit. Në mars kemi hapur thirrje për sektorin e vreshtarisë, për preparatet që i ka furnizuar komuna në luftimin e insektit të quajtur Cikadia. Në këtë muaj, po ashtu e kemi hapur një thirrje për organizatat që merren me përpunimin e perimeve dhe përfituese ka qenë qendra grupmbulluese "Agro Celina". Muaji prill, kryesisht është karakterizuar me aplikimin e fermerëve për subvencione në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë. Numri i fermerëve që kanë arritur të aplikojnë ka qenë 3064 dhe në krahasim me vitin e kaluar, 35 fermerë janë më pak. Në informatë jemi munduar t'i paraqesim edhe krahasimet në mes të vitete, 2024-2025 dhe shihet që sektori i drithërave (kulturat lavërtarë) ka pasur ngritje në 580 ha dhe e kemi një rënie te kulturat perimore prej 180 ha. Lajm i mirë është që sektori i blektorisë ka shënuar rritje, ku krahasimisht në vitet e kaluara ka qenë më i vogël.

**8. Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, janar – qershor 2025:**

**Elbunit Kryeziu:** Përshëndetje kryetar, kryesues, drejtorë, asambleistë. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka dy sektorë: Sektori për Shëndetësi dhe Sektori për Mirëqenie Sociale. Aktivitetet e drejtorisë gjatë këtij gjashtëmujori janë fokusuar kryesisht në ofrimin e shërbimeve mjekësore për qytetarët e komunës së Rahovecit dhe në përmirësimin e kushteve të punës për punonjësit shëndetësorë, si dhe në shqyrtimin me kohë të kërkesave të qytetarëve, kryesisht për ndihma momentale. Sa i përket ndihmave momentale financiare, për këtë gjashtëmujor janë të miratuara 296 kërkesa. Ka vazhduar ofrimi i shërbimeve mjekësore në dy ndërrime të QMF-së, në Krushë të Madhe dhe Ratkoc. Gjithashtu, është duke vazhduar shërbimi mjekësor "Kujdesi Shtëpiak", nga ora 08:00 deri në orën 20:00. Në Dejnë dhe Ratkoc, gjatë kësaj periudhe është shënuar përvjetori i dhurimit vullnetar të gjakut dhe ka vazhduar në Krushë të Madhe, Sapniq dhe Dobidol. Janë kryer vizitat sistematike për nxënës në shkollat e komunës së Rahovecit dhe janë bërë përgatitjet për aktivitetet e muajit tetor, që njihet si muaji kundër kancerit të gjirit. Në QKMF funksionon aparati i mamografisë, i cili shërben për identifikimin me kohë të kancerit të gjirit. Ky aparat vlerësohet të jetë një prej asateve më me rëndësi në mjekësinë primare dhe me një investim si ky, Komuna e Rahovecit ka investuar direkt në shëndetin e grave, si shtyllë kryesore e familjes dhe mirëqenies së saj. Janë evidentuar dhe janë shpërndarë ftesat për vaksinimin e fëmijëve në

komunën tonë. Është bërë renovimin i objektit të Hendikosit – investim nga drejtoria. Në QPS, në periudhën janar - qershor janë regjistruar gjithsej 376 raste të dhunës, 25 raste dhunë në familje. Në QKMF gjithsej janë kryer 58.217 shërbime. Deri në maj, janë bërë 31 lindje dhe për momentin jemi afër numrit 40.

**Defrim Kafexhiu:** Faleminderit drejtorit të QKMF-së për këto sqarime. Sa i përket QKMF-së e përmendi punën e ekipit mobil dhe besoj që është një veprim që duhet të përshëndetet, sepse janë shumë efikase. Te puna e QPS-së është një fenomen jo i mirë në komunën e Rahovecit. Kemi shumë raste të njerëzve me të meta mendore që janë papërkujdesje. Kam qejf që edhe kjo temë të përfshihet brenda këtij raporti dhe çka ka bërë Qendra për Punës Sociale për këtë individë që po e rrezikojnë edhe vetëveten, edhe të tjetët, sidomos në komunikacion?! Unë kam folur disa herë për QPS-në që absolutisht nuk e di a bëjnë diçka në këtë pjesë. Çka duhet të bëjë komuna për këta njerëz dhe ka ka bërë QPS-ja? Meqenëse drejtori i QKMF-së është këtu, atëherë një pyetje dhe përgjigjen mund ta marr me shkrim, sepse kryetari e përmendi që seanca të mos stërgjatet, sepse është vapë: Si drejtor i QKMF-së si je ndier në konkursin e fundit, kur i ke pritur 5 infermierë në bazë të konkursit të fundit dhe ju kanë ardhur edhe 5 të tjerë? A e ke pasur problem t'i sistemosh?

**Kryetari:** E para, ky nuk është drejtori i QPS-së, por e ka prezentuar një informatë që është e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale, në dakordim me Sarandën, e cila nuk është këtu. Unë jam kryesues i mekanizmit koordinues komunal për dhunën në baza gjinore, dhunën në familje dhe ndaj gruas. Në këtë mekanizëm janë të përfshirë: Prokuroria, policia, gjyqtarët, shtëpia e shëndetit mendor – Gjakovë, Shtëpia e Sigurt etj... Ka shumë raportime dhe është një koordinim në mes të QPS-së dhe QKMF-së, në mes të QPS-së dhe policisë, në mes të QPS-së dhe prokurorisë, në mes të QPS-së dhe shtëpisë së shëndetit mendor në Gjakovë etj... Janë disa sfida që i diskutojmë me policinë dhe me këto mekanizma, sepse shteti ynë ende nuk ka ndërtuar kapacitete për trajtimin e njerëzve që kanë nevoja të caktuara. Ndërkaq, Qendra për Punë Sociale ka staf profesional, ashtu siç ka edhe Qendra e Mjekësisë Familjare. Para se të merreni me politika ditore, që janë normale edhe ato, mirë është të merreni me politika të cilat nuk kanë të bëjnë me pyetje sugjestive, sepse pyetjeve sugjestive nuk i përgjigjemi.

**Kryesuesi:** Faleminderit, kryetar! A kemi edhe ndonjë pyetje apo diskutim tjetër? Nëse jo, këtu e përfundojmë mbledhje e shtatë të rregullt dhe shihemi në mbledhjen e radhës.

| | |
|---|---|
| **Procesmbajtësi:** | **K R Y E S U E S I** |
| ___________________ | ___________________ |
| **Albion Krasniqi** | **Arbër Zenuni** |

**Republika e Kosovës**

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

***Komuna e Rahovecit***

*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*

**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

---

# Informatë për gjendjen e mbeturinave në Komunën e Rahovecit

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
-III- Nr. I prot / Br. prot. 2635 Më / Dt. 08.08.2025
RAHOVEC - ORAHOVAC











Një ndër sfidat kryesore në përmirësimin e gjendjes së mjedisit në Kosovë mbetet menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave. Me gjithë arritjet dhe progresin në forcimin e bazës ligjore dhe programore për sektorin e mbeturinave, me gjithë përmirësimin e infrastrukturës për menaxhimin e tyre, mbetet ende angazhim dhe punë për përmirësimin e gjendjes në sektorin e mbeturinave.

Ne jemi të vetëdijshëm se për përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave nevojitet një bashkëpunim më efikas dhe i qëndrueshëm i institucioneve dhe i organizatave përgjegjëse në të gjitha nivelet.

Përveç angazhimit të institucioneve ligjvënëse dhe ekzekutive, rol të rëndësishëm në sektorin e mbeturinave kanë edhe kompanitë menaxhuese të grumbullimit të mbeturinave, kompanitë që menaxhojnë deponitë sanitare të mbeturinave, organizatat e shoqërisë civile, donatorët dhe aktorët e tjerë.

Aktualisht, vështirësitë dhe problemet në sektorin e mbeturinave janë evidente në të gjitha proceset e menaxhimit të tyre, që nga grumbullimi, ndarja, riciklimi, trajtimi dhe deponimi.

Por, besojmë fuqishëm që me një angazhim dhe kordinim më të mirë Komuna e Rahovecit mund të arrijë të ndërtojë një sistem modern dhe funksional për menaxhimin e mbeturinave komunale.

Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave do të ndihmojë në realizimin e synimit primar që ka Komuna e Rahovecit , përmirësimin dhe ruajtjen e mjedisit dhe resurseve tona natyrore për ne dhe për gjeneratat që do të vijnë pas nesh.

Qëllimi kryesor i Raportit është informimi i publikut për gjendjen e mbeturinave komunale në Komunën e Rahovecit, mirëpo përmes këtij raporti synohet që të ndikohet edhe në përmirësimin e politikave për menaxhimin e mbeturinave.

## 1. RAPORT PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

- Operatorët e Menaxhimit të Mbeturinave,
- Menaxhimi i Mbeturinave,
- Sfidat në Menaxhimin e Mbeturinave,
- Korniza lokale ligjore,
- Masat aktuale për zvogëlimin e sasisë së mbeturinave,
- Gjendja ekzistuese.

Në Komunën e Rahovecit menaxhimi i mbeturinave nuk është në gjendje të keqe vetëm duhet të vetëdijesohemi mos të hedhim mbeturina vend e pa vend që të krijojmë deponi ilegale, kemi punuar edhe jemi duke punuar vazhdimisht ti largojmë deponitë ilegale po ashtu edhe jemi në përfundim të aksionit me të gjitha shkollat e komunës sonë.

Kemi organizuar kampanjën për largimin e deponive ilegale gjithmonë me raportet nga GIZ-i gjerman dhe nga Agjensioni për mbrojtjen e mjedisit poashtu edhe JICA Japoneze ka bërë regjistrimin ne muajin shtator te deponive ilegale.

Janë larguar deponitë me përmasa të mëdha në fshatra dhe qytet. Vazhdimisht kemi sfide kete dukuri.

Bashkë duhet të bëjmë thirrje dhe fushata vetedijesuese qe mbeturinat nuk kemi nevojë ti hedhim në ambiente kudo por ato kane vend ku hedhen, ne mënyrë qe ambienti ynë të jete i pastër, këto ambiente duhet ti kthejmë në hapësira gjelbëruese për ne dhe fëmijët tanë ***me nje moto"Ambienti i Pastër jeta e Shëndetshme".***

## SFIDAT NË MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Sektori i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë është përballur me plotë sfida për një kohë të gjatë tani. Ndërsa ende përpiqet të krijojë një sektor stabil me impakte negative të imponuara në mjedis dhe shëndet publik, organizatat ndërkombëtare janë duke i dhënë rëndësi të madhe çështjes së mbeturinave, dhe duke e bërë këtë që të ndihmojë Kosovën të arrij një zhvillim mjedisor të qëndrueshëm.

Sfidat në menaxhimin e mbeturinave janë :

- Mbeturinat kimike industriale ,
- Mbeturinat medicinale ,
- Mbeturinat shtazore dhe
- Mbeturinat elektronike të cilat nuk janë drejtpërdrejtë në kompetencë të komunës edhe pse në komunën tonë nuk kemi mbeturina kimike dhe elektronike por mbeturina shtazore dhe medicinale .

## KORNIZA LOKALE LIGJORE

Bazuar në kornizën kushtetuese në të cilën principe autoritetet kosovare qeverisin, duhet garantuar mbrojtja e mjedisit për qytetarët. Sipas nenit 7, "Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mos diskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut." .

Komuna ka përzgjedhur deponinë ku do të hedhen mbeturinat nga konstruktimi dhe demolimi.

Mbulimi i shërbimeve në territorin e Komunës është i përfshirë në të gjithë territorin e komunës sonë në 36 vendbanimet.

Jemi në hapa të mire dhe gjithçka besoj do të rregullohet por ne jemi ata që duhet ti ndihmojmë mjedisit ku jetojmë ta menaxhojmë mbeturinat mirë që te kemi mjedis të pastër .

Komuna e Rahovecit duhet të përcaktojë mënyrën e inkasimit të mjeteve financiare dhe caktimin e tarifave, të bëjë vlerësimin e kompanive dhe monitorimin e tyre, gjithashtu të monitorohet mirë procesi i tenderimit, përzgjedhja e operatorit për grumbullimin dhe trajtimin e mbeturinave dhe të zhvillojë pilot projektin për eliminimin e deponive ilegale dhe përmirësimin e gjendjes mjedisore në komunë.

Sqarim shtesë: duke e ditur se ne çdo seance kemi pasur raportime qofte te menaxhimit te mbeturinave dhe mirëmbajtjes se hapësirave publike, kam kërkuar një raport detal nga dy kompanitë me informata shtese se ne muajin e fundit si është gjendja me mbeturina.

Shih ne kete dokument ju bashkangjesim edhe raportet nga dy kompanitë.

KOMPANIA REGJIONALE PËR MBETURINA
"EKOREGJIONI" SH.A. PRIZREN
Njësia Rahovec

Adresa : Sheh Mihedini
Tel:038-738-048
Email: krm_ecoregjioni@yahoo.com
info@ekoregjioni.com

Numër:

Date: 30.07.2025

Përshëndetje ,

Në bazë të emailit të pranuar nga ana e juaj , ku keni kërkuar gjendjen e menaxhimit te mbeturinave në Rahovec , ju paraqesim këtë raport.

1. **Zbatimi i Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave**
   KRM "Ekoregjioni" Sh.a., Njësia në Rahovec, është duke e zbatuar në përpikëri Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave Nr. 44, të datës 30.03.2023.
2. **Rritja e tarifës për deponimin e mbeturinave**
   Po, nga janari i vitit 2025 është për 1 € për ton, duke arritur në 10.05 € për ton. Nga janari i vitit 2026 tarifa do të rritet në 11.05 € për ton. Sipas planifikimit, çmimi pritet të rritet çdo vit me nga 1 €, në deponinë e mbeturinave në Landovicë.
3. **Shuma aktuale e tarifës për mbeturina**
   Sipas rregullores aktuale, tarifat janë si më poshtë:
   - Për amvisëritë rezidente: 6.00 € në muaj
   - Për amvisëritë jorezidente: 27.00 € në vit
   - Për subjektet afariste: tarifa janë të ndara në pesë kategori, për tri zona të ndryshme, ku **tarifa më** e ulët është 5.00 € dhe më e larta arrin në 22.96 €.
4. **Ndryshimet pas përfundimit të projektit JICA**
   Deri më tani, nuk ka pasur ndryshime të reja. Të gjitha aktivitetet dhe shërbimet vazhdojnë të kryhen sipas dinamikave të parashikuara nga kompania.
5. **Replikimi i edukimit mjedisor në shkolla**
   Aktualisht nuk është zhvilluar ndonjë aktivitet edukativ nëpër shkolla.
6. **Grumbullimi i kapakëve/plastikave/kanaçeve**
   KRM Ekoregjioni nuk ofron shërbimin për mbledhjen e kapakëve, plastikave apo kanaçeve. Ato hidhen në mënyrë individuale nga qytetarët dhe bizneset në vendgrumbullime të caktuara.
7. **Monitorimi i materialeve të riciklueshme në shkolla**
   Nuk realizohet monitorim i materialeve të riciklueshme të grumbulluara nëpër shkolla.
8. **Përdorimi i databazës së klientëve**
   Kompania jonë përdor programin Rikont dhe ka një databazë të veçantë për menaxhimin e të dhënave të klientëve.
9. **Bartja e regjistrave në databazën PP4**
   Databaza e përmendur (PP4) nuk është e njohur për kompaninë tonë, prandaj nuk kemi pasur ndonjë aktivitet në lidhje me të.
10. **Menaxhimi i mbeturinave vëllimore**
    Në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, janë realizuar disa aksione për mbledhjen e mbeturinave vëllimore në qytet dhe në fshatrat ku operojmë. Gjithashtu, janë të angazhuar punëtorë për këtë aktivitet.
11. **Statusi i tenderit për shërbimin e mbledhjes së mbeturinave**
    Kjo çështje nuk është në kompetencë të kompanisë sonë.

**K.R.M.Ekoregjioni-Prizren**
**Njësia Rahovec**

"EKO-DRINIA"SH.P.K

Ratkoc-Rahovec

Përshëndetje,

Në paraqesim bazë të emailit të pranuar nga ana e juaj, ku keni kërkuar gjendjen e menaxhimit te mbeturinave në Rahovec, ju paraqesim kete raport te gjendjes

1. **Zbatimi i Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave Menaxhimin**
   "Eko-Drinia"Sh.p.k Ratkoc, është duke e zbatuar në përpikëri Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave Nr.01/23 dt.30.03.2023 te nxjerrë nga Kuvendi Komunal Rahovec
2. **Rritja e tarifës për deponimin e mbeturinave**
   **Po, ka pasë rritje te tarifave nga "KMDK"-gjegjesisht Qeveria e Kosoves dhe atë:** është rritur për 1.08€ qdo vit per ton dmth. 2023 **7.89€** për ton,2024 **8.97€** per ton,2025 **10.05€** per ton. Në vitini 2026 tarifa do të rritet në **11.14 €** për ton.dhe ne vitin 2027 tarifa do te jetë **12.21 €** Sipas planifikimit, çmimi priten te rriten edhe pas vit 2027 qdo vit nga "K.M.D.K"
3. **Shuma aktuale e tarifës për mbeturina Sipas rregullores aktuale, tarifat janë si më poshtë:**
   a)Për amvisëritë rezidente: 6.00 € në muaj Për amvisëritë jorezident: 27 € në vit ose 2.25 € muaj
   b) Për subjektet afariste: tarifa janë të ndara në pesë kategori, për tri zona të ndryshme, ku tarifa më e ulet ështe 5.00€, mesatarja 12.80€ dhe ajo me larta 66.95€ per konenjtenjera 7.0m3
4. **Ndryshimet pas përfundimit të projektit JICA**
   Deri më tani, nuk ka pasur ndryshime të reja. Të gjitha aktivitetet dhe shërbimet vazndojnë të kryhen sipas dinamikave dhe planit operativ te kompanisë.
5. **Replikimi i edukimit mjedisor në shkolla**
   Aktualisht nuk është zhvilluar ndonjë aktivitet edukativ nëpër shkolla.
6. **Grumbullimi i kapakëve/plastikave/kanaçeve**
   "Eko-Drinia" nuk ofron shërbimin për mbledhjen e kapakëve, plastikave apo kanaçeve. Ato hidhen në mënyrë individuale nga qytetarët dhe bizneset në vendgrumbullime të caktuara.
7. **Monitorimi i materialeve të ricikluesh me në shkolla**
   Nuk realizohet monitorim i materialeve të ricikluesh me të grumbulluara nëpër shkolla
8. **Përdorimi i databazës së klientëve**
   Kompania jonë përdor programin "Exel" dhe ka një database filter t për menaxhimin e të dhënave të klientëve.
9. **Bartja e regjistrave në databazën PP4**
   Databaza e përmendur (PP4) nuk është e njohur për kompaninë tonë, prandaj nuk kemi pasur ndonjë aktivitet në lidhje me të.
10. **Menaxhimi i mbeturinave vëllimore**
    Në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, janë realizuar disa aksione për mbledhjen e mbeturinave vëllimore si dhe ka nje plan dy here ne vit I cili realizohet ne menyre jashtezakonisht te mire në fshatrat ku operojmë. Gjithashtu, janë të angazhuar punëtorë për shtesë këtë aktivitet si dhe bartja e ketyre mbeturinave behet ne deponinë"Gavne" te caktuar nga komuna e Rahovecit dhe ne te cilen ne kete deponi ka te angazhuar puntor qe behet riparimi I ketyre dhe pastaj dhurohen per persona qe kane nevojë
11. **Statusi i tenderit për shërbimin e mbledhjes së mbeturinave**
    Kjo çështje nuk është në kompetencë të kompanisë sonë.

Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara EKO-DRINIA Ratkoc-RAHOVEC

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo

Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipal of Rahovec

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
-III- Nr. i prot / Br. prot. 2366 Më / Dt. 15.07.2025
RAHOVEC - ORAHOVAC

Nga: z. Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit

# PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

## të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2024

| Nr | Komponent a e auditimit (kapitulli) | Gjetja | Rekomandimi | Veprimet e planifikuara për tu ndërmarre | Zyrtar përgjegjës | Data e planifikuara e zbatimit të rekomandimit | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | **Çështja A1** Mos plotësimi i kritereve sipas kërkesave në formularin për aplikim | Manuali për implementim të Rregullores MF-nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, pika 3.4 parasheh formularët e detyrueshëm për aplikim, të cilët duhet të aplikohen në secilin rast të thirrjes publike, ndër të tjera edhe Formulari i aplikacionit të programit ose projektit (Formulari F9), parasheh informacion të detajuar mbi aplikuesin dhe informacion mbi përmbajtjen e projektit/programit duke përfshirë gjendjen financiare, burimet njerëzore, partneritetet, përvojën dhe të dhëna të ngjashme.<br>Në tre (3) raste të subvencionimit të OJQ-ve, formulari (F9) nuk ishte i plotë, pasi në përmbajtjen e projektit/programit, mungonin informacionet e detajuara në lidhje me burimet njerëzore, partneritetet, përvojën dhe të dhëna të ngjashme, siç kërkohet me manualin/rregulloren përkatëse për subvencionim të OJQ-ve. Detajet e këtyre rasteve janë: OJQ KF "Rahoveci" e cila kishte përfituar subvencione në vlerë 30,000€, në emër të projektit për fuqizimin e | Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme në lidhje me zbatimin e kërkesave të manualit/rregullores përkatëse, me rastin e subvencionimit të OJQ-ve | Ky rekomandim duke përfshire të gjitha pikat e cekura në këtë rekomandim do të zbatohen gjatë vitit 2025. | Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport<br><br>Përgjegjës për: Zbatimin e procedurave për subvencionimin e OJQ-ve, monitorimin dhe kontrollin e dokumentacionit. | 2025 | Qëllimi ynë është të rrisim transparencën, përgjegjshmërinë dhe efikasitetin në menaxhimin e fondeve publike të dedikuara për sektorin joqeveritar, duke siguruar që mbështetja financiare të shkojë për projekte me ndikim të matshëm në komunitet |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | sportit/futbollit; OJQ KF "Anadrini", e cila kishte përfituar subvencione në vlerë 9,000€ në emër të sportit/futbollit; si dhe OJQ "Art Studio", e cila kishte përfituar subvencione në vlerë 6,000€, në emër të projektit për organizimin e simpoziumit ndërkombëtar të artit.<br>Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme për zbatim të kërkesave të manualit/rregullores me rastin e subvencionimit | | | | | |
| 2. | **Çështja B1 - Vonesa në pagesën e faturave** | Neni 39.1 i LMFPP përcakton se ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.<br>Në shtatë (7) raste, faturat në total prej 235,731€ nuk janë paguar në afatin e paraparë ligjor. Vonesat në ekzekutimin e pagesave janë prej 19 deri në 516 ditë, pas afatit të lejuar për pagesë prej 30 ditëve.<br>Kjo kishte ndodhur për shkak mungesës së mjeteve dhe mangësive në menaxhimin e obligimeve. | Kryetari duhet të sigurojë fonde të mjaftueshme të mjeteve në mënyrë që të gjitha faturat e pranuara paguhen brenda 30 ditëve pas pranimit. | Ju sigurojmë se kjo çështje është marrë me seriozitet të plotë nga ana jonë dhe jemi të përkushtuar që praktika të tilla të mos përsëriten në të ardhmen. | Drejtoritë përkatëse, Zyra e Prokurimit, ZKA dhe ZKF | 2025 | Komuna e pranon gjetjen dhe do të ndërmarrë veprime konkrete për të përmirësuar menaxhimin e pagesave. Përmes bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet drejtorive dhe financave, do të sigurohet që të gjitha faturat të paguhen brenda afatit ligjor, duke mbrojtur integritetin financiar dhe bashkëpunimin korrekt me operatorët ekonomikë. |
| 3. | **Çështja A2** - Mungesë e informatave e të plota për menaxhimi | Sipas nenit 70.2 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik: "Vlerësimi i përformancës së kontraktuesve do të bëhet: i) në sistem të prokurimit elektronik nëpërmjet modulit për vlerësim të përformancës së kontraktuesve; ii) nga menaxherët e kontratës dhe mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, dhe iii) në pajtim me manualet për përdorim të modulit për vlerësim të përformancës së kontraktuesve". Më tutje, sipas nenit 70.24: | Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave mbajnë të dhënat e plota për menaxhimin e kontratave në modulin përkatës në | Identifikimi i të gjitha kontratave aktive dhe përditësimi i tyre në sistemin KRPP. | Zyrtari për Prokurim Menaxherët e kontratave Zyra e Kryetarit (për mbikëqyrje të përgjithshme) | 31.12. 2025 | Komuna e pranon rekomandimin dhe do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar që menaxherët e kontratave të mbajnë evidencë të plotë dhe |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | n e kontratave | "Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik".<br>Në tetë (8) kontrata, menaxherët e kontratave/projekteve nuk kanë mbajtur dhe arkivuar me informata të plota menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve në modulin përkatës në sistemin elektronik të prokurimit publik.<br>Kjo kishte ndodhur si rezultat i moskryerjes së punës me përgjegjësi nga ana e menaxherëve të kontratave dhe mbikëqyrësve të drejtpërdrejtë të tyre. | sistemin e prokurimit publik dhe vlerësimin e performancës sipas rregullave përkatëse. | | | | të përditësuar në sistemin përkatës. Qëllimi është të rritet transparenca, efikasiteti dhe kontrolli mbi zbatimin e kontratave publike. |
| 4. | **Çështja B2** - Vonesa në realizimin e projekteve | Sipas nenit 70.23 të Rregullores nr.001-2022 për prokurimin publik, menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë. Në kontratat e lidhura ndërmjet komunës dhe operatorëve ekonomik, janë përcaktuar afatet kohore të realizimit të kontratave.<br>Në pesë (5) raste, kemi evidentuar vonesa në realizimin e projekteve, si në vijim:<br>Kontrata për projektin "Rregullimi i shtretërve të lumenjve" në vlerë 815,988€, e nënshkruar më datën 02.09.2020, kishte vonesa në përfundimin e punëve. Sipas kushteve të kontratës, plani dinamik i realizimit të këtij projekti ishte deri më 02.09.2022, derisa projekti nuk është finalizuar ende;<br>Kontrata për projektin "Ndërtimi i depove bujqësore" në vlerë 424,397€, e nënshkruar më 13.10.2022, kishte vonesa në përfundimin e punëve. Sipas kushteve të kontratës, plani dinamik i realizimit të këtij projekti ishte deri më 01.02.2024, mirëpo ky projekt ende nuk është finalizuar;<br>Kontrata për projektin " Zhvendosja e rrjetit të trafos në sheshin qendror" në vlerë 67,412€ e lidhur më | Kryetari duhet të siguroj se para inicimit të projekteve për punë, të përmbushen kushtet e realizimit projektit si në aspektin teknik ashtu edhe në aspektin financiar, përmes hartimit të mirëfilltë të projekteve dhe sigurimit të mjaftueshëm të buxhetit në mënyrë që punët të realizohen sipas planit | Ju sigurojmë se për institucionin tonë do të jetë prioritet zbatimi i projekteve në kohë dhe me cilësi, dhe se jemi duke ndërmarrë hapa të qartë për të siguruar që vonesat e tilla të reduktohen në të ardhmen | Drejtoritë përkatëse, Zyra e Prokurimit, Menaxherët t Kontratave si dhe Zyra e Kryetarit | 2025 | Komuna e pranon gjetjen dhe është duke marrë masa për të përmirësuar planifikimin dhe mbikëqyrjen e projekteve kapitale. Me forcimin e menaxhimit të kontratave dhe angazhimin më të madh të drejtorive përkatëse, synohet minimizimi i vonesave dhe përmirësimi i realizimit të buxhetit zhvillimor. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 23.10.2023 kishte vonesa në përfundimin e punëve. Sipas kushteve të kontratës, plani dinamik i realizimit të këtij projekti ishte 23.11.2023, deri sa punimet ishin kryer sipas raportit teknik te punëve me datën 23.02.2024;<br>Kontrata për projektin "Ndërtimi i aneksit në shkollën fillore 4 dëshmoret në Ratkoc" në vlerë 899,991€ e nënshkruar më 10.11.2022, kishte vonesa në përfundimin e punëve. Sipas kushteve të kontratës, plani dinamik i realizimit të këtij projekti ishte deri më 10.03.2024, derisa projekti nuk ishte finalizuar ende; dhe<br>Kontrata për projektin "Ndërtimi i infrastrukturës për festivalin e rrushit në Bërnjak" në vlerë 156,605€, e nënshkruar më 08.07.2022, kishte vonesa në përfundimin e punëve. Sipas kushteve të kontratës plani dinamik i realizimit të këtij projekti ishte deri më 08.02.2023, derisa projekti ishte finalizua deri më 17.07.2024.<br>Vonesat në realizimin e projekteve kishin ndodhur si rezultat i planifikimit jo të mirë dhe mos përmbushjes së kushteve për realizim të projekteve para lidhjes së kontratave, si dhe për shkak të mungesës së mjeteve për përfundimin e tyre sipas dinamikës se paraparë. | | | | | |
| 5. | **Çështja A3** - Mos mbyllja e investimeve në vijim si dhe regjistrimi i tyre si pasurive në përdorim | Rregullorja 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive të Organizatave buxhetore, përcakton mënyrën e regjistrimit, mirëmbajtjes së regjistrave të pasurive, zhvlerësimin, procesin e inventarizimit, po ashtu sipas nenit 11 thuhet se pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zvlerësimi. | Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, duke siguruar pranimin teknik të projekteve të përfunduara dhe regjistrimin e tyre si | Identifikimi i të gjitha projekteve të përfunduara që ende figurojnë si investime në vijim.<br>Regjistrimi i pasurive në përdorim në SIMFK dhe | Zyrtari për Pasuri, Inventar dhe Regjistrim në SIMFK, Drejtori përkatëse Zyra e Kryetarit (për | Deri me 31.12. 2025 | Komuna e pranon rekomandimin.<br>Veprimet për përmirësimin e procesit të pranimit dhe regjistrimit të pasurive tashmë kanë filluar dhe do të intensifikohen me qëllim që pasqyrat financiare të paraqesin |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Gjatë testimit të pasurive kemi vërejtur se në 12 raste të pasurive të regjistruara si "Investime në vijim", pesë prej tyre janë në përdorim dhe janë pranuar teknikisht, ndërsa shtatë janë në përdorim por nuk janë pranuar teknikisht. Këto pasuri figuronin në regjistër si investime në vijim, edhe pse të njëjtat shfrytëzohen nga komuna dhe do të duhej të regjistroheshin si pasuri në përdorim dhe për to të kalkulohej zhvlerësimi.<br>Kjo kishte ndodhur për shkak të funksionimit mos funksionimit të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare ndër vite. | pasuri në përdorim në mënyrë që të njëjtat të raportohen drejtë dhe saktë. | regjistrin e pasurive jo financiare. Monitorim i rregullt i përputhshmërisë ndërmjet investimeve dhe pasurive të regjistruara. | mbikëqyrje të zbatimit) | | gjendjen reale të pasurisë së komunës dhe të minimizohen devijimet e mundshme. |
| 6. | **Çështja A4** - Menaxhimi jo efikas i llogarive të arkëtueshme | Sipas nenit 27.1. nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.<br>Gjithashtu sipas Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, komunat janë përgjegjëse për mbledhjen e të hyrave vetanake dhe duhet të kenë sisteme të përshtatshme për të siguruar regjistrimin, monitorimin dhe inkasimin e të gjitha të hyrave komunale.<br>Në pasqyrat financiare janë shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 2,653,115€. Pjesa më e madhe e këtyre llogarive i takon tatimit në pronë, me vlerë prej 2,253,324€ (rreth 85%), taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë me vlerë 382,630€ (rreth | Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga tatimpaguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, pa përjashtuar edhe veprimet ligjore me qëllim të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e të hyrave me kohë. | Dërgimi i njoftimeve me shkrim për borxhlinjtë, me afate për pagesë dhe paralajmërime për veprime ligjore. Vendosja e marrëveshjeve për pagesë me këste, ku është e mundur. Inicimi i procedurave përmbarimore ndaj borxhlinjve që refuzojnë pagesën | Departamenti i Tatimit në Pronë, Drejtoria për ekonomik dhe zhvillim. | Deri me 31.12. 2025 | Komuna e pranon rekomandimin. Jemi të vetëdijshëm për rëndësinë e mbledhjes së rregullt të të hyrave dhe menaxhimit efikas të borxheve. Do të ndërmerren masa konkrete për përmirësimin e procesit të arkëtimit dhe uljen e borxheve të pa mbledhura. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 14%) dhe qirasë për shfrytëzimin e pronës komunale me vlerë 17,161€ (rreth 1%).<br>**Në gjashtëmbëdhjetë (16) raste** në vlerë 111,039€, të **llogarive të arkëtueshme** nga tatimi në pronë dhe në tre (3) raste në vlerë 11,809€, të **llogarive të arkëtueshme nga taksa për ushtrimin** e veprimtarisë, komuna nuk kishte ndërmarrë veprime ligjore përmes përmbaruesit për mbledhjen e këtij borxhi, edhe pse ishte **tejkaluar afati** i përcaktuar në kontratë dhe **afati** në shkresat për rikujtimin e borxhit.<br>Kjo kishte ndodhur për shkak të kontrolleve dhe veprimeve të pamjaftueshme ligjore në arkëtimin e të hyrave sipas afateve. | | | | | |

**Republika e Kosovës**

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

*Komuna e Rahovecit*

*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*

**Smajl Latifi**

# Raport për zbatimin e Planit të Integritetit në Komunën e Rahovecit

Rahovec, Korrik 2025

# Përmbledhja


Hyrje .......... 3

Përmbledhje Ekzekutive .......... 4

Objektivat e Planit të Integritetit .......... 4

Vlerësimi i progresit .......... 5

I. Nënfushat e përgjithshme të rrezikut .......... 6

II. Nënfushat e veçanta të rrezikut .......... 7

Sfidat dhe Pengesat .......... 7

Rekomandime dhe hapat e ardhshëm .......... 7

Tabela për zbatimin e Planit të Imtegritetit në Komunën e Rahovecit .......... 8

# Hyrje

Komuna e Rahovecit, konform mandatit ligjor që ka dhe planit vjetor të punës për vitin 2025 ka paraparë që të harton edhe raportin për zbatimin e Planit të Integritetit të Komunës.

Plani i Integritetit është monitoruar nga koordinatori për monitorimin e zbatimit të tij dhe përfshinë të gjitha veprimet të cilat janë të pasqyruara në kuadër të këtij plani, si dhe informatat të cilat janë dhënë nga drejtorit, sektorët. Me qëllim të monitorimit të tij dhe analizës së zbatimit të masave/veprimeve, është hartuar raporti për periudhën janar - qershor 2025.

Raporti përfshinë periudhën janar - qershor, 2025 dhe përfshinë veprimet e ndërmarra në kuadër të fushave: **a).** fushave të përgjithshme të rrezikut dhe **b).** fushave të veçanta të rrezikut, të cilat janë vendosura në planin për Integritet. Andaj, edhe raporti është realizuar përmes informatave plotësuese nga ana e drejtorive. Mbi bazën e këtyre informatave, është arritur që të analizohet dhe vlerësohet gjendja aktuale e zbatimit të masave/veprimeve nga plani i veprimit.

**Metodologjia e përdorur,** gjatë monitorimit të planit të veprimit për Integritet në Komunën e Rahovecit, ka pasur një cikël të metodave:
1. Fillimisht është dërguar një email njoftues tek njësitë e komunës lidhur me veprimet dhe obligimet e tyre së bashku me planin e veprimit;
2. Janë dërguar edhe email-at rikujtues, në mënyrë që të plotësohet raporti për Planin e Integritetit;
3. Pas marrjes së planit të veprimit, janë analizuar masat/veprimet e raportuara, si dhe në fund është hartuar raporti për zbatimin e Planit të Integritetit të Komunës së Rahovecit për periudhën janar – qershor, 2025. Raporti është raport narrativ dhe statistikor.

**Të gjeturat**. Në bazë të informatave mbi zbatimin e Planit të Integritetit në Komunën e Rahovecit, në periudhën janar – qershor 2025 janë planifikuar: 2 fusha të rrezikut (1 fushë e përgjithshme dhe 1 fushë e veçantë), 17 nënfusha të rrezikut dhe 97 masa/veprime të propozuara për zbatim, nga të cilët janë zbatuar 96 masa ose 98.97%, dhe 1 masa/veprime ose 1.03% nuk është zbatuar ose nuk janë ofruar informata adekuate, gjë që e kemi poentuar si të pazbatuara.

Sa i përket ndarjes së fushave, në kuadër të fushës së përgjithshme të rrezikut, janë 4 nënfusha të rrezikut dhe 33 masa të propozuara, ku edhe janë të zbatuar të gjitha. Ndërsa, sa i përket fushës së rrezikut të veçantë, janë gjithësej 13 nënfusha të rrezikut dhe 64 masa të propozuara, nga të cilat 63 janë zbatuar dhe 1 masa/veprime ende jo. Për të gjitha masat/veprimet dhe informatat tjera, më poshtë i kemi dhënë sqarimet e hollësishme.

## Përmbledhje Ekzekutive

Raporti i përfshin dy (2) fusha të rrezikut, fushën e veçant dhe fushën e përgjithshme me gjithsejt shtatmbëdhjet (17) nënfusha, dhe gjithsej nëntdhjet e shtat (97) masa të propozuara, nga të cilat nëntdhjet e pesë (96) janë realizuar, dhe një (1) është në proces të realizimit.

Plani është monitoruar në vazhdimsi, dhe si referenc kanë qenë dokumentët e miratuara, aktet e nxjerrura të cilat kanë pas të bëjnë drejtpërdrejt me Planin e Integritetit apo në mënyrë të tërthort.

Gjatë monitorimit si sfid ka qenë identifikimi i rreziqeve të reja të cilat mundë të ndikojn në integritetin e institucionit dhe që do të ndikonte në mënyrë negative në imazhin apo besimin e institucionit, dhe për këtë është bërë përpjekje në identifikimin e rreziqeve të mundshëme që mundë të paraqiten në të ardhmen, dhe mënyrën e ndërhyrjës për paraqitjën, përfshirjën në plan të këtyre rreziqeve, dhe ndërmarrjën e masave të nevojshme për parandalimin e këtyre rreziqeve.

Në fazat e më vonshme do të bëhet ndryshimi i këtyre masave në bazë të rreziqeve të mundëshme që mundë të paraqitën.

Planin për integritet është i publikuar në web faqen e komunës https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/01/Plani-Komunal-per-Integritet-2024-2027.pdf

## Objektivat e Planit të Integritetit

Objektivi kryesor i Planit të Integritetit është të rrisë dhe rendit përpjekjet dhe burimet për të parandaluar/eliminuar në mënyrë progresive dhe sistematike shkaqet dhe efektet shkatërruese të korrupsionit dhe të sjelljeve jo etike në Komunë.

Objektivat specifike janë:

- Sigurimi i një mekanizmi gjithëpërfshirës, ku të gjithë individët dhe njësitë në Komunë, si dhe qytetarët mund të përfshihen në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në punën e organeve të administratës komunale.

- Rritja e vetëdijesimit të qytetarëve mbi rreziqet e korrupsionit dhe të sensibilizojë qytetarët dhe bizneset për rolin e tyre në parandalimin/eliminimin e korrupsionit dhe sjelljeve jo etike.

- Përmirësimi dhe forcimi i mekanizmave të raportimit të rasteve të korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në Komunë.
- Rritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve komunale.
- Krijimin dhe mirëmbajtjen e partneriteteve në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike.

## Vlerësimi i progresit

Më posht mundë të njiheni më detaisht me mënyrën e realizimit, zbatimit të masave

- ➢ Masa është zbatuar në kohën e duhur; **22**
- ➢ Masa është zbatuar pas afatit;**1**
- ➢ Masa është zbatuar në mënyrë periodike; **73**

- ➢ Masa nuk është zbatuar për shkak të menaxhimit joadekuat të procesit;
- ➢ Masa nuk është zbatuar për shkak të menaxhimit joadekuat të institucionit;
- ➢ Masa nuk është zbatuar për shkak të mungesës së burimeve njerëzore;
- ➢ Masa nuk është zbatuar për shkak të mungesës së buxhetit;
- ➢ Masa nuk është zbatuar për arsye të tjera; **1**
- ➢ Masa nuk është zbatuar për shkak se ende nuk është arritur afati për zbatimin e masës;

## I. Fusha e përgjithshme e rrezikut

Në kuadër të kësaj fushe janë gjithësej 4 nënfusha të rrezikut me gjithësej 33 masa të propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve, ku edhe janë të zbatuar të gjitha. Të gjitha këto të dhëna, i kemi pasqyruar si vijon:




Diagrami 1: *Progresi i arritu në fushën e përgjithshme në kuadër të zbatimit të Planit për Integritet në Komunën e Rahovecit (janar –qershor, 2025).*

## II. Fusha e veçant e rrezikut

Në kuadër të kësaj fushe janë gjithsej 13 nënfusha të rrezikut me gjithësej 64 masa të propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve nga të cilat 63 janë të realizuara dhe në proces janë edhe 1 masa, si vijon:




Diagrami 2: *Progresi i arritur fushën e veçantë në kuadër zbatimit të Planit për Integritet në Komunën e Rahovecit (janar –qershor 2025).*

## Sfidat dhe Pengesat

Gjatë monitorimit të Planit për Integritet sfid ka qenë identifikimi i rreziqeve të mundëshme që mundë të paraqiten, dhe ndërmarrja e masave të reja në mënyrë të parandalimit të rrezikut të mundëshëm.

## Rekomandime dhe hapat e ardhshëm

Në të ardhmen duhet të zgjerohet grupi punues për plotësim ndryshimin e planit me nga një zyrtar prej secilës drejtori apo njësi, në mënyrë që të identifikohen rreziqer e mundëshme, dhe ndërmarrja e masave të nevojshme në mënyrë të parandalimit të rrezikut.

# Tabela për zbatimin e Planit të Imtegritetit në Komunën e Rahovecit

| Të dhënat e Planit të Integritetit | | | | | | Raportimi i zbatimit | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Fusha e Rrezikut | Përshkrimi i Rrezikut | Masa e propozuar | Njësia/zyrtari përgjegjës | Afati i realizmit | Veprimet e ndërmarra | Niveli i realizmit | Mjetet e verifikimit | Vështirësitë | Rekomandimet |
| 1 | DREJTIMI DHE MENAXHIMI | Objektivat dhe prioritetet e zhvillimit të komunës të paqarta dhe jo transparente si dhe mos përfshirja e të gjitha fushave përkatëse për zhvillimin e komunës në Planin Zhvillimor. | Zhvillimi i metodologjisë për hartimin e Planit Zhvillimor të komunës dhe zbatimin e saj. | Kryetari i Komunës, Kryetari i Kuvendit, drejtuesit e organeve dhe drejtuesit e drejtorive komunale | 6 muaj | 1. Projekt Plani Zhvillimor Komunal 2023-2031, është miratuar, ky plan ka marr pëlqimin për miratim nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, po ashtu ka marr miratimin e Kuvendit Komunal. | E Realizuar | https://kk.rks-gov.net/rahovec/?newscpt=miratohet-plani-zhvillimor-komunal-per-tete-vitet-e-ardhshme-2023-2031 | Gjatë fazës përgaditore ka pasur vështirësi në procedin e hartimi dhe të miratimit, si dhe marrjën e pëlqimit. | Pas zbatimit të kësaj mase, kjo mundë të largohe nga Plami për Integritet |
| 2. | | | Sigurimi i pjesëmarrjes së përfaqësuesve të të gjitha fushave përkatëse si dhe | | 6 muaj | 2. Plani Zhvillimor Komunal 2023-2031 ka kaluar dy faza të hartimit, gjatë përgaditjes së draft Planit ku janë mbajtur 15 takime me qytetar në lokacione të ndryshme. Dhe faza pas marjes së pëlqimit për shqyrtim publik nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrstrukturës po ashtu ka marr miratimin e Kuvendit Komunal. | E Realizuar | https://kk.rks-gov.net/rahovec/?cat=317 | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | qytetarëve në zhvillimin e Planit Zhvillimor të komunës | | | | Janë mbajtur 12 takime me qytetar, përfaqsues të bizneseve, OJQ-ve dhe asambleistve, ku janë informuar për përmbajtjen dhe mundësin që kanë për kërkesa, propozime dhe ankesa. Shqyrtimi publikë është mbajtë prej datës 18.01.2023 deri 18.02.2023 ku janë pranuar gjithësej 51 kërkesa. Është formuar komisioni me vendim të kryetarit për shqyrtim të kërkesave. Kërkesat e aprovuar do përfshihen në Planin Zhvillimor Komunal 2023-2031. | | | | |
| 3. | | Opinion publik negativ dhe humbja e besimit të publikut në punën e administratës komunale dhe Kuvendit Komunal për shkak të transparencës së pamjaftueshme | Përditësimi i informatave në ueb faqen e Komunës për t'i informuar qytetarët dhe mediat për aktivitetet e komunës | Kryetar i i Komunës, Kryetar i i Kuvendit, drejtuesit e drejtorive komunale | Në vazhdimësi | 3. Në baza ditore, bëhet përditësimi i informatave, aktiviteteve dhe lajmeve për ngjarjet që ndodhin në dhe për institucionin e komunës së Rahovecit. Transmetimi i mbledhjeve të Kuvendit bëhet online në Ueb faqen zyrtare, kanalin youtobe dhe facebook. | E Realizuar | https://kk.rks-gov.net/rahovec/?page_id=200000069 | | Duhet në vazhdimësi të bëhet përditësimi informative. |
| 4. | | | Informimi i vazhdueshëm i qytetarëve me procedurat për hartimin | Kryetar i i Komunës, Kryetar i i Kuvend | Në vazhdimësi | 4. Në të gjitha grupet punuese për hartimin e akteve, rregulloreve dhe planeve një anëtar i përket shoqërisë civlile. Poashtu bazuar në Udhëzimin Administrativ për standardet minimale të konsultimeve publike publikohen me kohë (14 ditë para) aktet dhe rregulloret, si dhe | E Realizuar | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | dhe miratimin e akteve me interes publik me qëllim të përfshirjes së tyre në vendimmarrje | it dhe drejtuesit e drejtorive komunale | | njoftimet për konsultime publike, duke iu mundësuar secilit që të ketë mundësi të jap sugjerime dhe vërejtje dhe kështu të bëhet direkt pjesë e vendimmarrjes komunale. | | | | |
| 5. | | Mospërputhja dhe paqartësia e përgjegjësive në administratën komunale | Rishikimi i organizimit të brendshëm të administratës përmes Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. | Kryetari i komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtori i Administratës drejtuesit e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve | 9 muaj | 5. Kryetari i Komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve. analizojnë dhe rishikojnë detyrat e punës sipas Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. | E Realizuar | https://kk.rks-gov.net/rahovec/?cat=317 | | Ndryshimi, plotësimi i rregulloresë. |
| 6. | | Mos përcaktimi i qartë i | Të përcaktohen përgjegjësit | Kryetari i Komu | 1 muaj | 6. Me vendim të kryetarit është caktuar Koordinatori për Integritet, i cili së bashku me drejtorët e drejtorive | E Realizuar | NRP-2587-02 Vendim për ca | | Pas zbatimit kjo masë duhet të largohet nga Plan për Integritet. |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | përgjegjësive për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Planit të Integritetit | ë sa i përket monitorimit dhe raportimit për zbatimin e Planit të Integritetit | nës dhe drejtuesit e organeve komunale koordinatori | | përkatëse, bën monitorimin e zbatimit të Planit për Integritet, si dhe raportimin në lidhje me zbatimin e tij. | | | | |
| 7. | | Mos përcaktimi i qartë i përgjegjësive për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Planit të Integritetit | Të monitorohet dhe raportohet rregullisht zbatimi i Planit të Integritetit | Kryetar i i Komunës dhe drejtuesit e organeve komunale koordinatori | 1 muaj | 7. Që nga caktimi i koordinatorit, janë marr masa për monitorimin dhe përditësimin e masave të zbatuara. | E Realizuar | | | |
| 8. | | Mos monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin e Planit të Integritetit | Të rishikohet niveli i zbatimit dhe të përditësohen masat për përmirësime. | Menaxheri i integritetit, Koordinatori dhe Grupi Punues i integritetit . | 6 muaj | 8. Koordinatori së bashku me drejtorët e drejtorive përkatëse bën rishikimin e nivelit të zbatushmërisë së masave të propozuara. | E Realizuar | https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/01/Plani-Komunal-per- | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Integritet-2024-2027.pdf | | |
| **9.** | **POLITIKA E BURIMEVE NJERËZORE, SJELLJA ETIKE DHE PROFESIONALE E TË PUNËSUARVE** | Mos plotësimi i vendeve të punës me staf adekuat dhe të mjaftueshëm | Zhvillimi dhe miratimi i Planit të Personelit | Kryetari i Komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive | 9 muaj | 9. Në shtator çdo vit bëhet plani i personelit, miratimi dhe zbatimi i tij. | E Realizuar | https://kk.rks-gov.net/rahovec/?cat=317 | | |
| **10.** | | Profesionalizmi dhe kompetenca e pamjaftueshme e të punësuarve. | Zbatimi i parimit të meritës gjatë procedurave të punësimit | Kryetari i Komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive | Në vazhdimësi | 10. Pranimi i zyrtarëve të rijnë, bëhet në bazë të kriterve të përcaktuara, në konkurse, sipas meritës; | E Realizuar | https://konkursi.rks-gov.net/ | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **11.** | | | Të bëhet analiza e nevojave për trajnime | Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive eprorët | Në vazhdimësi | 11. Bëhet analiza e nevojave për trajnim kohë pas kohe, në bazë të analizave, nevojës për trajnim, mbahen trajnime të kohë pas kohëshme. | E Realizuar | | | |
| **12.** | | | Trajnimi i vazhdueshëm i të punësuarave | | Në vazhdimësi | 12. Të punësuarit në administratën komunale vazhdojnë të trajnohen varësisht sipas fushave. Për periudhën janar - qershor 2025, janë dërguar zyrtar në IKAP (Instituti i Kosovës për Administrat Publike) për trajnim. | E Realizuar | | | Duhet të vazhdoj trajnimi i zyrtarv |
| **13.** | | | Të bëhet vlerësimi i ndikimit të trajnimeve të mbajtura | | Në vazhdimësi | 13. Bëhet vlersimi i ndikimeve të trajnimeve, efekti i tyre; IKAP është institucion i cili bënë vlerësimin e trajnimeve të mbajtura. Ndërsa, NJBNJ koordinon procesin e trajnimeve me IKAP. NJBNJ mbanë databazën në excel për të gjitha trajnimet e mbajtura nga IKAP, por nuk bënë vlerësim të trajnimeve pasi që kjo është në mandatin e IKAP-it. Çdo zyrtar që merr pjesë në trajnim pas përfundimit të trajnimit plotëson formularin e vlerësimit të trajnimit në IKAP. | E Realizuar | https://ikap.rks-gov.net/ | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 14. | | Përshkrimet e vendeve të punës të nëpunësve të pa qarta, jo adekuate dhe të pa përditësuara | Të bëhet rishikimi dhe standardizimi i detyrave të punës si dhe harmonizimi i tyre me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. | Kryetari i Komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve. | 9 muaj | 14. Kryetari i Komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve. analizojn dhe rishikojn detyrat e punës sipas Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. | E Realizuar | | | |
| 15. | | | Të harmonizohen përshkrimet e vendeve të punës me proceset dhe procedurat përkatëse të punës. | Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive dhe udhëheqësit | 9 muaj | 15. Përshkrimi i vendeve të punës është realizuar dhe është harmonizuar sipas Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe sipas Katalogut të vendeve të punës. | E Realizuar | Rregullore Organizimin e | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | e sektorëve | | | | | |
| 16. | | | Të ju ri-dorëzohet përshkrimi i vendit të punës të gjithë nëpunësve | Njësia e Burimeve Njerëzore, të gjithë nëpunësit | Në vazhdimësi | 16. Njësia e Burimeve Njerëzore, analizon dhe rishikon detyrat e punës sipas Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. Deri më tani është bërë rishikimi i detyrave të punës sipas Rregullores. | E Realizuar | | | Të nxirret një rregullore e re, e cila do të specifikonte dhe rregullonte në mënyrë të qart sistematizimin e vendeve të punës |
| 17. | | Delegimi i kodit komunal të etikës për gjithë zyrtarët komunal përfshirë zyrtarët publik, të zgjedhurit dhe të emëruarit. | Raportimi i zbatimit i Kodit të Etikës për gjithë zyrtarët komunal përfshirë zyrtarët publik, të zgjedhurit dhe të emëruarit | Kryetari i Komunës dhe Kuvendit, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive dhe udhëheqësit | Në vazhdimësi | 17. Raportohet në vazhdimsi për zbatimin e Kodit të Etikës. | E Realizuar | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | e sektorëve | | | | | | |
| 18. | | Mungesa e informimit dhe sensibilizimit për ekzistencën e kodit të etikës për stafin drejtues dhe stafin tjetër të komunës | Shpërndarja e Kodit të Etikës për të gjithë zyrtaret komunal dhe organizimi i takimeve për informim me përmbajtjen e Kodit. | Kryetari i Komunës dhe i Kuvendit, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve | Në vazhdimësi | 18. Sipas të dhënave brenda NJBNJ-së, të gjithë zyrtarët janë të pajisur me Kodin e Etikës. | E Realizuar | | | |
| 19. | | Mungesa e informimit dhe mos raportimit të dhuratave nga qytetarët tek punëtorët e | Njësisë për Burime Njerëzorë krijion një regjistër për regjistrimin e dhuratave | Njësia e Burimeve Njerëzore, të gjithë | Në vazhdimësi | 19. NJBNJ mban evidencë për dhuratat, si dhe e informon stafin për rregullat e pranimit të dhuratave. | E Realizuar | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Komunës (neni 17 dhe 18 i Rregullore (QRK - Nr. 04/2015 Për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës) | të pranuara nga nëpunësit; | nëpunësit publik | | | | | | |
| 20. | | | Të informohet stafit për rregullat e pranimit të dhuratave. | | Në vazhdimësi | 20. Zyrtarët rregullisht informohen për rregullat e pranimit të dhuratave. | E Realizuar | | | |
| 21. | | Niveli i pamjaftueshëm i ndërgjegjësimit të punonjësve për raportimin e korrupsionit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme brenda institucionit. | Të sigurohet mbajtja e takimeve të rregullta ndërmjet menaxhmentit dhe personelit për prezantimin dhe diskutimin për mekanizmat | Kryetari i Komunës dhe Kuvendit dhe drejtuesit e drejtorive Njesia e | Në vazhdimësi | 21. Mbahen takime të rregullta për prezantimin dhe diskutimin e raportimit të korrupsionit, dhe të aktiviteteve të tjera të pa ligjëshme. | E Realizuar | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | e raportimit të korrupsionit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme. | personelit | | | | | | |
| 22. | | | Të gjithë nëpunësit publik të punësuar dhe ata të cilët do të rekrutohen, të nënshkruajnë deklaratën e integritetit në bazë të secilës nëpunësi do të merr përgjegjësin ë përkatëse | Njësia e Burimeve Njerëzore, të gjithë nëpunësit publik | Në vazhdimësi | 22. Është nënshkruar deklarata për integritet nga ana e të gjithë nënpunsve publik, me të cilën marrin përgjegjësit lidhur masat që i parashe plani për integritet | E Realizuar | | | |
| 23. | **PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMI I BUXHETIT DHE** | Planifikimi jo adekuat i buxhetit vjetor komunal. | Të sigurohet pjesëmarrja e të gjitha palëve relevante gjatë planifikimit të buxhetit; | Kryetari i Komunës dhe drejtuesit e drejtorive | Në vazhdimësi | 23. Kryetari i Komunës së bashku me drejtorët e drejtorive relevante mban dëgjime buxhetore në bazë të ligjit, në të gjitha vendbanimet e Komunës, me OJQ, Sindikata, Biznese etj. | E Realizuar | https://kk.rks-gov.net/rahovec/?cat=317 | | Të vazhdohet me informimin e vazhdushëm rreth degjimeve bugjetore. |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | FINANCAVE | | | | | | | | | |
| 24. | | | Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive përkatëse për personelin për planifikim të buxhetit | Kryetari i komunës Njësia e Burimeve Njerëzore | Në vazhdimësi | 24. Me vendim te ZKF (Zyrtari Kryesor Financiar) dhe ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) përzgjidhen punonjësit e Komunës qe të ndjekin trajnimet në modulet: shpenzues, zotues, pranues etj. | E Realizuar | | | |
| 25. | | Shpenzimi i buxhetit jo në mënyrë adekuate dhe jo mjaftueshëm transparent | Hartimi dhe miratimi i raporteve dhe planit të shpenzimeve | Kryetari i Komunës dhe drejtoria për buxhet dhe financa | 1 muaj | 25. Vazhdohet hartimi më i detajuar në mënyrë që miratimi i raporteve të shpenzimeve të kryhet ashtu siç është bërë planifikimi i buxhetit. | E Realizuar | | | |
| 26. | | | Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore. | Drejtoria për Buxhet dhe Financa | Në vazhdimësi | 26. Drejtoria për Buxhet dhe Financa e bënë raportimin e rregullt të shpenzimeve buxhetore në bazë të raporteve periodike. | E Realizuar | https://kk.rks-gov.net/rahovec/?cat=31150 | | |
| 27. | | | Publikimi i planit të shpenzimev | Njësia për | Në vazhdimësi | 27. Këto raporte gjithmonë publikohen në ueb faqen e Komunës. | E Realizuar | https://kk.rks-gov.net/ra | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | e në ueb faqen e komunës | Informim | | | | hovec/?cat=31150 | | |
| 28. | | | Të sigurohet mbikëqyrja e jashtme mbi zbatimin e buxhetit duke krijuar një komision të përbërë nga përfaqësuesit e komunës dhe nga vëzhgues të OJQ-ve për të monitoruar zbatimin e buxhetit. | Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa | 3 muaj | 28. Drejtoria për Buxhet dhe Financa përkatësisht zyrtari kryesor financiar i prezanton raportet financiare në secilin tremujor. | E Realizuar | | | |
| 29. | | | Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore dhe realizimin e buxhetit | Drejtoria për Buxhet dhe Financa | 3 muaj | 29. Drejtoria për Buxhet dhe Financa përpilon dhe raporton, raporte financiare në baza mujore. | E Realizuar | | | |
| 30. | | Inventarizimi dhe regjistrimi joefikas i | Të përditësohet regjistri i brendshëm i | Drejtoria për Ekonomi, | 6 muaj | 30. Në vazhdimësi bëhet përditësimi i aseteve komunale nga zyrtari përgjegjës. | E Realizuar | | | Të vazhdohet me përditësimin e regjistrave të aseteve komunal |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | aseteve komunale | aseteve të komunës | Zhvillim dhe Turizem | | | | | | |
| 31. | **RUAJTJA DHE SIGURIA E TË DHËNAVE DHE DOKUMENTACIONIT** | Siguria e pamjaftueshme e të dhënave në sistemet e teknologjisë informative si dhe përdorimi i tyre për qëllime jozyrtare | Zhvillimi dhe miratimi i procedurës së punës për proceset që realizohen përmes sistemeve të teknologjisë informative | Kryetari i Komunës, Drejtoria e Administratës dhe sektori i TIK | Në vazhdimësi | 31. Në vazhdimësi përdoret sistemi i intranetit për krijimin e kërkesave, procesimin e kërkesës deri tek përfundimi i lëndës dhe njoftimin e palës për atë lëndë, pastaj është po ashtu platforma konkursi online (https://konkursi.rks-gov.net), ku zhvillohen procedurat për aplikim dhe njoftim, në platformën e-kosova ofrohen shërbime për nxjerrjen e faturës së tatimit në pronë, gjendjes civile, taksa komunale (https://ekosova.rks-gov.net/Services). | E Realizuar | https://konkursi.rks-gov.net), | | |
| 32. | | | Të sigurohet informimi për të gjithë të punësuarit lidhur me rrezikut nga mashtrimet dhe korrupsioni që kanë të bëjnë me sigurinë e informacionit dhe shfrytëzimin | Drejtoria e Administratës dhe sektori i TIK | Në vazhdimësi | 32. Në vazhdimësi punonjësit informohen nga ASHI (Agjencioni Shtetror i Kosovës) dhe stafi i TIK-ut (Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit) kur ka tentime të mashtrimeve. | E Realizuar | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | e të dhënave të kompjuterizuara | | | | | | | |
| 33. | | Trajtimi jo adekuat i dokumentacionit zyrtar dhe informacionit | Zhvillimi dhe miratimi i procedurës së brendshme mbi trajtimin e dokumentacionit dhe informacionit zyrtar | Kryetari i Komunës, Drejtoria e Administratës | Në vazhdimësi | 33. Pikënisja e procedurës është qendra për shërbim të qytetarëve, ku fillon procedura e kërkesave nga personat zyrtarë apo juridik, zhvillohet procedura e brendëshme për realizimin e kërkesës (trajtohet nga departamenti përkatës) dhe pas përfundimit jepet informacioni mbi lëndën e trajtuar. | E Realizuar | | | |
| 34. | **AUDITIMI I BRENDSHËM** | Mungesa e planifikimit të auditimit të bazuar në rrezik dhe auditimeve rast pas rasti | Të sigurohet planifikim efektiv i auditimit i bazuar në rezultatet e vlerësimit të rrezikut dhe të monitorohet zbatimi i këtij plani si dhe të planifikohen masa përmirësues | Kryetari i Komunës, Komisioni i auditimit, Njësia e Auditimit | Në vazhdimësi | 34. Ekziston Plani i cili bazohet në vlerësimin e rrezikut. Me Planin e vitit 2025 janë realizuar të gjitha aktivitetet e parapara deri në këtë fazë dhe plani është monitoruar dhe realizuar në 100%. | E Realizuar | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | e në rast nevoje. | | | | | | | |
